



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI VJETOR I PERFORMANCËS 2024

Prishtinë, prill 2025

Përmbajtja

Fjalori i shprehjeve	3
Fjala e Auditorës së Përgjithshme	4
Vizioni, Misioni dhe Vlerat	6
Përmbledhje ekzekutive	8
Baza e Raportit Vjetor të Performancës	13
Kapitull I - Korniza ligjore dhe Qeverisja e Brendshme	17
1.1. Pavarësia dhe Korniza ligjore	17
1.2. Pavarësia institucionale	17
1.3. Mandati	18
Kapitull II - Qeverisja e brendshme dhe etika	21
2.1. Planifikimi strategjik, operativ dhe plani vjetor	21
2.2. Mjedisi i kontrollit organizativ	22
2.3. Komunikimi i brendshëm	23
Kapitulli III - Planifikimi, realizimi dhe cilësia e auditimeve	25
3.1. Auditimet e planifikuara për sezonin e auditimit 2024/2025	25
3.2. Auditimet e realizuara në vitin 2024	26
3.3. Cilësia e auditimit dhe raportimi	27
3.4. Rezultatet e auditimit dhe adresimi i rekomandimeve të auditimit financiar dhe të pajtueshmërisë	28
3.5. Auditimet e performancës	32
3.6. Kontrolli i cilësisë	38
3.7. Bashkëpunimi me organet e sundimit të ligjit	39
Kapitulli IV - Menaxhimi Financiar dhe Administrativ	41
4.1. Menaxhimi financiar	41
Kapitulli V - Burimet Njerëzore	47
5.1. Burimet Njerëzore dhe zhvillimi profesional	47
5.2. Zhvillimi profesional dhe trajnimi i personelit	49
5.3. Shërbimet e përbashkëta	52
5.4. Teknologjia informative	53
5.5. Prokurimi	53
Kapitulli VI - Komunikimi dhe bashkëpunimi me palët e jashtme	55
6.1. Komunikimi me mediat, qytetarët, organizatat e shoqërisë civile, donatorët dhe palë të tjera	55
6.2. Bashkëpunimi i ZKA-së me Kuvendin e Kosovës	57
6.3. Bashkëpunimi ndërkombëtar, marrëveshjet bilaterale dhe procesi i integritetit në Bashkimin Evropian	57
6.4. Bashkëpunimi dhe marrëveshjet e nënshkruara	60
6.5. Bashkëpunimi ndërkombëtar në Projektin me SNAO	60
6.6. Tryezat, punëtoritë dhe konferencat e organizuara nga ZKA-ja	60
Kapitulli VII - Llogaridhënia dhe aktivitetet e vitit 2024	63
7.1. Llogaridhënia e Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA)	63
7.2. Aktivitetet e ZKA-së gjatë vitit 2024	63
Shtojcat	66
Shtojca I. Auditimet për Sezonin 2023/24 dhe 2024/25	67
Shtojca II. Pasqyrat Financiare Vjetore të ZKA-së për vitin 2024 të pa audituara	71

FJALORI I SHPREHJEVE

AB	Auditori i Brendshëm
AP	Auditori i Përgjithshëm
BE	Bashkimi Evropian
BK	Buxheti i Kosovës
EUROSAI	Organizata Evropiane e Institucioneve Supreme të Auditimit
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit (ONISA)
ISA	Institucioni Suprem i Auditimit
KA	Komiteti i Auditimit
KIDP	Korniza e INTOSAI-t për Deklaratat Profesionale
KBT	Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere
KMFP	Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
NP	Ndërmarrje Publike
OB	Organizata Buxhetore
OSHC	Organizatat e Shoqërisë Civile
PFV	Pasqyrat Financiare Vjetore
PSH	Prokuroria e Shtetit
RVP	Raporti Vjetor i Performancës
RVA	Raporti Vjetor i Auditimit
RFV/BK	Raporti Financiar Vjetor i Buxhetit të Kosovës
RTK	Radio Televizioni i Kosovës
SIMFK	Sistemi Informativ për Menaxhimin e Financave të Kosovës
SNA	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
SNAO	Zyra Kombëtare e Auditimit të Suedisë
SNISA	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
SITA	Sistemin Informativ i Teknologjisë së Auditimit
TI	Teknologjia Informative
ZKA	Zyra Kombëtare e Auditimit

FJALA E AUDITORES SË PËRGJITHSHME



Vlora Spanca
Auditore e Përgjithshme

Roli kryesor i Auditorit të Përgjithshëm dhe Institucionit Suprem të Auditimit të një Shteti është të siguroj transparencë, llogaridhënie dhe menaxhim adekuat të fondeve dhe burimeve tjera publike. Ato duhet të arrijnë këtë përmes përmbushjes së auditimeve të aktiviteteve, proceseve dhe menaxhimit financiar publik në tërësi, në mënyrë të pavarur, të ndershme dhe profesionale.

Unë si Auditore e Përgjithshme e Republikës së Kosovës, së bashku me stafin e Zyrës Kombëtare të Auditimit përgjatë gjithë vitit 2024 kemi vazhduar më përkushtim, jo vetëm për të kryer punën e auditimit, por edhe për të përmirësuar dhe avancuar shtyllat kryesore që përbëjnë themelin e një institucioni kombëtar të auditimit, si besimi në radhë të parë tek publiku, Kuvendi e pastaj edhe te palë të tjera të interesit, përfshirë gjithashtu, kompetencën profesionale, objektivitetin dhe transparencën publike. Qëllimi ynë kryesor është menaxhimi i qëndrueshëm i parasë publike dhe përmirësimi i mirëqenies së qytetarëve.

Vizioni im strategjik ka qenë rritja e besueshmërisë në raportet e auditimit dhe stafi ynë ka punuar me përkushtim për të siguruar se çdo auditim përmbush standardet më të larta ndërkombëtare, duke ndihmuar në identifikimin e dobësive dhe në marrjen e masave për përmirësim të vazhdueshëm. Aktivitetet tona janë dizajnuar për të ofruar vlerë të shtuar për institucionet që auditojmë, duke kontribuar në rritjen e besimit për Zyrën tonë si një mekanizëm që ndihmon në përmirësimin e përgjegjshmërisë në menaxhimin e fondeve publike. Për tri vite rresht, Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është duke udhëhequr si lider në rajon për sa i përket besimit të qytetarëve në Institucione Supreme të Auditimit.

Ne vazhdojmë të mbajmë një nivel dinamik të mbulueshmërisë me auditime, duke u përpjekur të përmbushim pritjet e Kuvendit dhe tatimpaguesve tanë. Ne po arrijmë çdo vit të zgjerohemi me auditime, qoftë në dimension të vëllimit, kompleksitetit, gjithashtu edhe të pritshmërive në interes të publikut dhe palëve tjera relevante.

Ndikimi i auditimit është thelbësor për një administratë të përgjegjshme dhe transparente. Për të përmirësuar këtë ndikim, ne kemi realizuar hapa të rëndësishëm në planifikimin dhe zbatimin e auditimeve, duke siguruar efikasitet dhe konsistencë në procese.

Gjatë këtij viti, zyra jonë ka arritur përparime të rëndësishme në optimizimin e procedurave të auditimit dhe përmirësimin e kapaciteteve tona. Ne kemi investuar në trajnimin e stafit dhe në avancimin e teknologjive të auditimit, duke rritur efikasitetin dhe cilësinë e punës dhe rezultateve. Ne vazhdojmë të rishikojmë proceset tona dhe të promovojmë një kulturë reflektimi dhe përmirësimi brenda zyrës. Megjithatë, identifikimi i sfidave mbetet një prioritet për ne. Analizat tona tregojnë se është e nevojshme

të vazhdojmë komunikimin dhe koordinimin me palët e interesit. Këto zhvillime na japin shpresë për të ardhmen dhe na inkurajojnë që të vazhdojmë punën për të forcuar kapacitetet e institucioneve tona dhe për të siguruar një administratë publike më të përgjegjshme.

E kemi përmbushur në tërësi Planin Vjetor të Auditimit 2023/24. Përveç auditimeve të rregullta, janë realizuar gjithashtu auditime të pajtueshmërisë dhe performancës, janë mbuluar në tërësi ndërmarrjet publike më të mëdha dhe më komplekse. Po ashtu, janë audituar projekte të financuara nga Banka Botërore, me fokus ato me interes të lartë për qytetarët.

Për të përmirësuar menaxhimin e fondeve publike dhe për të arritur më shumë vlerë për para në vitin 2024, kemi dhënë 817 rekomandime për institucionet e nivelit qendror dhe lokal e që krahasuar me një vit më parë, kemi rënie të numrit të tyre. Kjo tregon për përmirësime në procese të caktuara. Ka pasur përmirësime në cilësinë e raportimit financiar nga institucionet publike, duke rritur besueshmërinë në pasqyra financiare dhe promovuar llogaridhënie dhe transparencë. Numri i opinionëve të modifikuara është zvogëluar, megjithëse më shumë përmirësime kërkohet në veçanti tek organizatat e nivelit lokal. Pavarësisht sfidave të mëtejshme, përmirësimet e arritura në institucione publike janë rezultat i masave të ndërmarra dhe ndikimit të rekomandimeve tona.

Duhet theksuar se, përkundër zvogëlimit të numrit të rekomandimeve, niveli i zbatimit të tyre nuk ka qenë i kënaqshëm, vetëm 46% janë zbatuar e që krahasuar me vitin paraprak është shënuar një rënie prej 3%.

Gjatë vitit 2024, ne kemi informuar Prokurorin e Shtetit dhe organet e tjera të hetuesisë për elemente potenciale të veprave penale.

Pas një periudhe të gjatë të ushtrimit të veprimtarisë në ambiente private, vendimi i Qeverisë për të ndarë një objekt publik për zyrën tonë është mirëpritur dhe paraqet një zgjidhje afatgjatë e cila, përveç që do kursejë buxhetin për qiranë dhe do të garantojë trajtimin e merituar për institucionin tonë, njëkohësisht do të shmang Zyrën nga ekspozime të mundshme të cenimit të parimeve etike.

Komunikimi me palët e interesit, përfshirë shoqëritë civile, është përmirësuar për të rritur transparencën në menaxhimin e financave publike. ZKA ka qenë aktive në shumë dimensione, si brenda ashtu edhe jashtë vendit për të mirëmbajtur, ruajtur dhe promovuar kompetencën profesionale dhe imazhin e saj.

Duke e përfunduar fjalën time, me bindje e them se rezultatet tona nuk do të ishin të mundura pa mbështetjen edhe të palëve të tjera, në veçanti të Kuvendit të Kosovës, por edhe bashkëpunimin e entiteteve të audituara. Por, më e rëndësishmja, stafi im i cili punon me përkushtim për të përmbushur misionin tim dhe Zyrës Kombëtare të Auditimit. Në këtë rast, shpreh mirënjohjen e pafund për të gjithë të përfshirët në punën tonë.

Me respekt,
Vlora Spanca
Auditore e Përgjithshme

Prishtinë, 2025



VIZIONI

Institucion Suprem i Auditimit i besueshëm dhe model që i shton vlerë përdorimit të fondeve publike.



MISIONI

Nëpërmjet auditimeve cilësore ofrojmë siguri në shfrytëzimin e pasurive dhe parasë publike, me qëllim të përmirësimit të ofrimit të shërbimeve për qytetarë dhe rritjen e llogaridhënies publike.



VLERAT E ZYRËS KOMBËTARE TË AUDITIMIT (ZKA)

Pavarësia

Pavarësia nënkupton që i gjithë procesi i auditimit t'i nënshtrohet vetëm kërkesave të standardeve profesionale dhe të jetë jashtë ndikimit të palëve të treta. Pavarësia është elementi kryesor për të siguruar besimin e publikut dhe të Kuvendit të Kosovës, duke u ofruar atyre informacione të besueshme dhe të paanshme.

Profesionalizmi

ZKA udhëhiqet në veprimtarinë e saj audituese nga principet dhe standardet në kuadër të Kornizës së Deklaratave Profesionale të ONISA/INTOSAI dhe nga praktikat më të mira të vendeve tjera.

Integriteti

ZKA angazhohet për mishërimin e vlerave më të mira etike, profesionale dhe morale. Veprimtaria e auditimit kryhet në mënyrë të ndershme dhe jashtë çdo konflikti të interesit.

Transparenca

ZKA është organizatë e hapur dhe do t'i bëj publike të gjitha aktivitetet e saj të rëndësishme. Po ashtu do t'i ofroj publikut të gjerë informacionin e përfituar nga auditimi, në përputhje me rregullat ligjore dhe standardet profesionale. ZKA angazhohet që të promovoj transparencën edhe në subjektet e audituara, si një element i qeverisjes së mirë.

Fryma ekipore

Në ZKA procesi i auditimit kryhet në mënyrë profesionale dhe bashkëpunues në mes kolegëve në ekip dhe në nivele të ndryshme organizative, kështu promovojmë frymën ekipore si vlerë e shtuar për ZKA-në.

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Në vitin 2024, Zyra Kombëtare e Auditimit ka vazhduar të përmbushë mandatin e saj kushtetues dhe ligjor duke ofruar informacione të pavarura dhe objektive për Kuvendin e Kosovës dhe qytetarët. Kjo ka ndihmuar në vlerësimin e mënyrës se si institucionet publike kanë menaxhuar paratë publike, nëse kanë vepruar në përputhje me kërkesat ligjore dhe me efikasitet, përfitimet e të cilave shkojnë në dobi të qytetarëve.

Plani Vjetor i Auditimit për sezonin 2023/2024 është realizuar në mënyrë të plotë, duke e tejkaluar planifikimin¹. Gjatë vitit 2024 kemi kryer gjithsej 127 auditime, prej të cilave 108 ishin auditime financiare dhe të pajtueshmërisë, 14 auditime të performancës, si dhe 5 auditime të pajtueshmërisë (prej tyre 3 auditime të klasifikuara)-angazhime të drejtpërdrejta të raportimit².


Në kuadër të auditimeve gjatë këtij sezoni auditues, përveç organizatave buxhetore janë përfshirë edhe ndërmarrje publike si institucione më komplekse: Korporata Energjetike e Kosovës (KEK), Trepça, Kompania për Operimin e Sistemit të Transmetimit të Tregut të Energjisë Elektrike (KOSTT), Ndërmarrja Publike Banesore (NPB). Gjatë kësaj periudhe, është kryer monitorimi i zbatimit të rekomandimeve, si dhe janë shqyrtuar proceset e administrimit dhe menaxhimit të buxhetit dhe burimeve njerëzore. Po ashtu, i është kushtuar vëmendje e veçantë komunikimit të brendshëm dhe palëve të jashtme të interesit.

1 PVA mbulon periudhën e sezonit të auditimit shtator –gusht, ndërsa RVP mbulon vitin kalendarik prandaj edhe mund të dallon edhe numri i auditimeve sipas këtyre dy raporteve.

2 Sipas SNISA 4000 ekzistojnë dy lloje kryesore të auditimeve të veçanta të pajtueshmërisë “angazhim direkt i raportimit” dhe “angazhim i vërtetimit. Në angazhimet e raportimit të drejtpërdrejtë të kryera me siguri të arsyeshme, audituesit deklarojnë në përfundimin e auditimit se lënda është ose nuk është në përputhje në të gjitha aspektet materiale me kriteret e zbatueshme, ndërsa në një “angazhim vërtetimi” me siguri të arsyeshme, konkluzionet e auditorëve shprehin pikëpamjet e tyre se informacioni i çështjes është ose nuk është në përputhje me kriteret e zbatueshme.

Rezultatet e punës audituese për vitin 2024

NUMRI I AUDITIMEVE SIPAS LLOJIT



- **Auditimet financiare dhe të pajtueshmërisë** - Fokusi kryesor i këtyre auditimeve ka qenë cilësia e raportimit financiar (*nëse pasqyrat vjetore financiare prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në secilin aspekt material*), efikasiteti dhe efektiviteti i sistemeve të kontrollit të brendshëm, pajtueshmëria e veprimeve të subjekteve të audituara me kornizën ligjore, si dhe aspekte të tjera që lidhen me vlerën për para.
- **Auditimet e performancës** - Këto auditime kanë mbuluar fushat me interes për qytetarët, Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe palët e tjera të interesit, me fokus në: mirëqenien ekonomike, sociale, arsim dhe kulturë, menaxhim, shëndetësi, zhvillim dhe buxhet, prokurim publik dhe teknologji të informacionit.
Në fushën e teknologjisë së informacionit, është kryer një auditim paralel me Kontrollin e Lartë të Shtetit të Shqipërisë i cili ka mbuluar temën “barazia gjinore dhe fuqizimi i grave nga zonat rurale nëpërmjet përfshirjes së tyre në tregun e punës”.
- **Auditimet e pajtueshmërisë** - Fokusi i auditimeve ka qenë pajtueshmëria me kornizën ligjore.

Rezultatet kryesore nga Raporti Vjetor i Auditimit për vitin 2023

Cilësia e raportimit financiar ende vazhdon të mos jetë në nivelin e pritur për shkak se nga 86 auditimet mandatore, për pasqyrat vjetore financiare, 35 prej tyre kishin keqdeklarime materiale, të cilat kanë rezultuar me opinion të modifikuar/kualifikuar, ndërsa 51 të tjera kanë rezultuar me opinion të pamodifikuar. Prej tyre, 48 OB të nivelit qendror, kanë përmirësim në lidhje me raportimin financiar, ku në vitin 2023 janë 12 OB me opinione të modifikuara ndërsa në vitin paraprak ishin 17 me opinione të modifikuara, përdërisa tek 38 OB të nivelit lokal, është një gjendje jo e mirë sa i përket raportimit financiar, ku në vitin 2023 ka 23 opinione të modifikuara që krahasuar me vitin paraprak ishin vetëm 16 opinione të modifikuara. Prezantimi i saktë dhe i plotë i informatave financiare e rrit besueshmërinë e lexuesve ndaj raportimit financiar.

Po ashtu, tek 86 OB mandatore, gjendja në lidhje me pajtueshmërinë nëse aktivitetet dhe transaksionet po kryhen në pajtim me kornizën ligjore ishte jo e mirë sidomos te niveli lokal. Në vitin 2023 nga 86 OB-të e audituara 37 kishin konkluzion të pamodifikuar kurse 49 e kishin konkluzionin e modifikuar. Prej tyre, tek 48 OB të nivelit qendror, 14 ishin me konkluzionin e modifikuar, përderisa tek 38 OB të nivelit lokal, 35 e kishin konkluzionin e modifikuar. Në raport me vitin paraprak gjendja është pothuajse e njëjtë.

Konkluzioni i përgjithshëm është se organizatat buxhetore në nivelin qendror kanë bërë përmirësime si në aspektin e raportimit financiar ashtu edhe në aspektin e pajtueshmërisë me kornizën ligjore, përderisa organizatat e nivelit lokal nuk kanë ndonjë progres.

Cilësia e raportimit financiar edhe pse krahasuar me vitin e kaluar është përmirësuar, megjithatë edhe te ndërmarrjet publike ende vazhdon të mos jetë në nivelin e pritur. Nga 12 auditimet e pasqyrave financiare të ndërmarrjeve publike, tek tre NP është dhënë opinion i pamodifikuar, ndërsa te nëntë të tjera opinion i modifikuar (pesë opinione të kualifikuara dhe katër të kundërta).


Po ashtu, tek NP, gjendja në lidhje me pajtueshmërinë nëse aktivitetet dhe transaksionet po kryhen në pajtim me kornizën ligjore, krahasuar me vitin paraprak, dy ndërmarrje kanë bërë progres duke kryer aktivitetet dhe transaksionet e tyre në pajtim me kornizën ligjore, ndërsa ndërmarrjet tjera në raste të caktuara nuk kishin kryer transaksionet dhe aktivitetet në pajtueshmëri me ligjet dhe rregulloret në fuqi. Ndërsa, sa i përket performancës financiare, tetë prej tyre kanë operuar me fitim, ndërsa katër tjerat kanë operuar me humbje.

Auditimet financiare dhe të pajtueshmërisë kanë identifikuar dobësi të rëndësishme në menaxhimin e financave të organizatave buxhetore dhe ndërmarrjet publike, përfshirë realizimin e transaksioneve që shpesh nuk janë në përputhje me kornizën ligjore, klasifikimin jo adekuat të shpenzimeve dhe mangësi në regjistrimin e pasurive. Çështje të tjera të shënuara përfshijnë raportimin e dobët të detyrimeve të paguara dhe procedurave të prokurimit, të cilat kontribuojnë në keqmenaxhimin e burimeve. Pavarësisht progresit gjatë vitit 2023, auditimet tregojnë se shumë ndërmarrje publike vazhdojnë të përballen me parregullsi në shpenzimet e pagave, menaxhimin e të hyrave dhe raportim të drejtë në pasqyra financiare. Auditimet e performancës gjatë vitit 2024 zbulojnë gjithashtu mangësi në fushat ekonomike, shëndetësore dhe të mirëqenies sociale, duke treguar për mungesën e efikasitetit dhe llogaridhënies në ofrimin e shërbimeve për qytetarët. Të gjitha këto çështje theksuan nevojën për përmirësime në menaxhimin e burimeve dhe rritjen e transparencës në operacionet e organizatave publike. Këto tregojnë për mungesën e efikasitetit, llogaridhënies, efektivitetit dhe mos arritjen e vlerës për paratë e shpenzuar dhe shërbimeve ndaj qytetarëve.

Zbatimi i rekomandimeve

Në raportet e auditimit të realizuara në vitin 2024 janë dhënë gjithsej 817 rekomandime (institucioneve qendrore, të pavarura dhe lokale, ndërmarrje publike dhe auditime të performancës).

Vlerësimi i zbatimit të rekomandimeve të vitit paraprak




Kjo tregon një mungesë veprimi nga institucionet përkatëse.

Në përgjithësi, organizatat buxhetore përgatitin plane të veprimit për zbatim të rekomandimeve, megjithatë nuk ndjekin ndonjë proces formal të monitorimit, vlerësimit apo raportimit mbi shkallën e progresit. Kjo pasqyron mungesën e përgjegjësisë për të siguruar që rekomandimet zbatohen me kohë dhe pengesat për veprim, identifikohen dhe adresohen.


Në mënyrë që situata të përmirësohet, nevojitet rritje e përkushtimit dhe llogaridhënies nga personat përgjegjës dhe monitorimi i rregullt i zbatimit të rekomandimeve nga të gjitha OB-të.

Menaxhimi financiar dhe administrativ i ZKA-së, në vitin 2024



Buxheti final ishte i ndarë në katër kategori ekonomike:

- Paga dhe shtesa në vlerë **2,168,374€;**
- Mallra dhe Shërbime në vlerë **729,021€;**
- Shërbime komunale në vlerë **40,000€ dhe**
- Investime kapitale në vlerë **156,000€.**



ZKA ka investuar në zhvillimin e kapaciteteve profesionale të stafit auditues për të siguruar që ata të jenë në hap me zhvillimet ndërkombëtare në fushën e financave, auditimit dhe fushave tjera relevante.

Komunikimi dhe përfaqësimi me palët e jashtme

ZKA në vitin 2024 ka zhvilluar komunikim efektiv me publikun si dhe ka qenë pjesë aktive në shumë takime, punëtori dhe konferenca brenda dhe jashtë vendit duke kultivuar një bashkëpunim të ngushtë me partnerët si në nivel kombëtar ashtu edhe në atë ndërkombëtar.

ZKA gjatë vitit 2024 është angazhuar në mënyrë aktive në avancimin e bashkëpunimit ndërkombëtar për të shkëmbyer praktikën më të mira dhe për të nxitur bashkëpunimin bilateral dhe multilateral me institucionet homologe në nivel regjional dhe global. Në aspektin ndërkombëtar është avancuar bashkëpunimi me Institucionet Supreme të Auditimit (ISA) përmes takimeve, punëtorive e aktiviteteve të tjera në kuadër të grupeve punuese dhe iniciativave të EUROSAI-t dhe INTOSAI-t, ndërsa në nivel regjional në kuadër të Rrjetit të ISA-ve, të vendeve kandidate dhe kandidatëve të mundshme për anëtarësim në BE dhe Gjykatës Evropiane të Auditorëve.

Bashkëpunimi me Kuvendin e Republikës së Kosovës, është intensifikuar kryesisht përmes punës me Komisionin për Mbikëqyrje të Financave Publike (KMFP) dhe Komisionin për Buxhet, Punë dhe Transfere (KBPT). Gjatë vitit 2024 (KMFP) ka shqyrtuar 24 raporte të auditimit, prej të cilave 15 raporte të auditimit financiar dhe pajtueshmëri dhe 9 raporte të auditimit të performancës për të cilat ka dhënë rekomandime për përmirësim për institucionet e audituara. Komisioni poashtu ka shqyrtuar edhe RVP-në e ZKA-së për vitin 2023 si dhe Raportin e Auditimit të jashtëm për PVF-të e ZKA-së për vitin 2023.

Vlerësimet për ZKA-në nga palët e jashtme për vitin 2024

Performanca e ZKA-së për këtë vit ka qenë subjekt i vlerësimeve të disa mekanizmave ndërkombëtar e vendor karshi opinionit publik, nivelit profesional dhe zbatimit të standardeve ndërkombëtare të auditimit. Disa nga vlerësimet që e nxjerrin ZKA-në nivel të lartë dhe japin nota pozitive janë: Vlerësimi për Integritetin i kryer nga Instituti Kosovar për Demokraci, Barometri Ballkanik i Këshillit për Bashkëpunim Rajonal si dhe analiza e OECD/SIGMA për nivelin e zbatimit të parimeve në administratën publike në Kosovë.

Sipas vlerësimit të Sistemit të Integritetit Kombëtar në Kosovë, për vitin 2023 dhe i publikuar në vitin 2024, realizuar nga Instituti Demokratik i Kosovës, ZKA-ja është renditur si institucioni me nivelin më të lartë të integritetit me 83.3 nga 100 pikë.

Barometri Ballkanik i Këshillit për Bashkëpunim Rajonal në raportin e publikuar për vitin 2024 në lidhje me nivelin e besueshmërisë në institucionet publike tregon se ZKA gëzon besim të lartë në nivel rajonal, si dhe renditet në një pozitë optimiste për ruajtjen e pavarësisë institucionale karshi ndikimeve politike, krahasuar me Institucionet Supreme të Auditimit të vendeve të tjera të rajonit.

Raporti “Administrata Publike në Kosovë - 2024” nga OECD/SIGMA, ka vlerësuar me 82 nga 100 pikë auditimin e jashtëm si efektiv dhe të pavarur, që siguron përdorimin e fondeve publike dhe ndihmon në përmirësimin e administratës publike në vend.

Këto rezultate janë një dëshmi dhe konfirmim i angazhimit të palodhur, transparencës dhe standardeve të larta etike dhe profesionale në të cilat ZKA-ja mbështet punën e saj.

Baza e Raportit Vjetor të Performancës

Në përputhje me nenin 14, të Ligjit Nr. 05/L-055, për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, Auditori i Përgjithshëm i dorëzon Kuvendit Raportin Vjetor të Performancës rreth aktiviteteve të Zyrës Kombëtare të Auditimit.

Ushtrimi i mandatit kushtetues dhe ligjor i ZKA-së, bazohet në strukturën e Kornizës së Matjes së Performancës së Institucioneve Supreme të Auditimit (ISA). Kjo kornizë u ofron ISA-ve mundësinë që të vlerësojnë nivelin e performancës së tyre kundrejt Standardeve Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA).

Kjo kornizë ka për qëllim që të kontribuojë në përmirësimin e mëtejshëm në zhvillimin e kapaciteteve të ISA-ve përmes menaxhimit dhe promovimit të matjes së performancës, si dhe identifikimin e mundësive për të forcuar dhe monitoruar performancën dhe llogaridhënien e ISA-ve.

Korniza e Matjes së Performancës së ISA-ve, si dokument standard i INTOSA-it, përmban gjashtë fusha kryesore:

- I. Pavarësia dhe Korniza Ligjore;
- II. Qeverisja e Brendshme dhe Etika;
- III. Fushëveprimi, Cilësia e Auditimit dhe Raportimi;
- IV. Menaxhimi financiar dhe administrativ;
- V. Burimet njerëzore;
- VI. Komunikimi dhe Bashkëpunimi me Palët e Jashtme dhe
- VII. Llogaridhënia dhe aktivitetet e vitit 2024.

Andaj Raporti Vjetor i Performancës së ZKA-së është hartuar dhe shpalosur në përputhje me fushat kryesore të kësaj kornize.

01

**Korniza ligjore dhe Qeverisja
e Brendshme**

Kapitull I - Korniza ligjore dhe Qeverisja e Brendshme

Pavarësia dhe qeverisja e brendshme reflektojnë përmbushjen e mandatit kushtetues dhe ligjor me qëllim të kryerjes së auditimeve cilësore në përputhje me SNISA.

1.1. Pavarësia dhe Korniza ligjore

Kjo fushë mbulon mandatin ligjor dhe pavarësinë e institucionit të Auditorit të Përgjithshëm (AP)³. Përveç Kushtetutës dhe ligjeve relevante, bazë e parimeve themelore të ISA-ve për këtë fushë janë: Deklarata e Limës (INTOSAI-P 1) dhe Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e ISA-ve (INTOSAI-P 10). Elementet tregues që ZKA-ja ka aplikuar për këtë fushë janë: pavarësia institucionale dhe kompetencat.

1.2. Pavarësia institucionale

Kushtetuta e Republikës së Kosovës e përcakton se Auditori i Përgjithshëm është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar në vend. Kompetencat themelore të AP-së janë përcaktuar me Kushtetutë dhe janë definuar më tej me ligjin e veçantë, Ligjin nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit (tutje "Ligji"). Në përputhje me ligj, Auditori i Përgjithshëm ka liri të plotë veprimi në kryerjen dhe ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave për të zbatuar mandatin e tij dhe është i pavarur në organizimin dhe menaxhimin e ZKA-së. Auditori i Përgjithshëm duhet të ketë pavarësi financiare, menaxheriale dhe administrative si dhe burime të mjaftueshme njerëzore, me qëllim të përmbushjes së mandatit ligjor.

Zyra Kombëtare e Auditimit është institucion i pavarur, i cili e ndihmon Auditorin e Përgjithshëm në kryerjen e detyrave të tij/saj. Misioni i Zyrës Kombëtare të Auditimit është të sigurojë auditime cilësore që kontribuojmë në llogaridhënien e sektorit publik, duke promovuar transparencën publike dhe qeverisjen e mirë, dhe duke nxitur ekonominë, efektivitetin dhe efikasitetin e programeve dhe projekteve të institucioneve publike për të mirën e të gjithëve.

3 Në këtë Raport, institucionit të Auditorit të Përgjithshëm do t'i referohemi edhe si Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA).

1.3. Mandati

Ky tregues vlerëson autoritetin operacional në organizimin e brendshëm, kompetencat dhe administrimit të ZKA-së, të përcaktuar në Kornizën Ligjore. Dimensionet për të vlerësuar këtë tregues janë: **Funksioni dhe Kompetencat** e gjera, qasja në informata, e drejta dhe detyrimi për të raportuar.

Në përputhje me nenin 136 dhe 137 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Auditori i Përgjithshëm është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili kontrollon:

- veprimtarinë ekonomike të institucioneve publike dhe të personave të tjerë juridikë shtetërorë;
- përdorimin dhe mbrojtjen e fondeve publike nga organet e pushtetit qendror dhe lokal;
- veprimtarinë ekonomike të ndërmarrjeve publike dhe personave të tjerë juridikë, tek të cilët Shteti ka një pjesë të aksioneve, ose kur huatë, kreditë dhe detyrimet e tyre garantohen nga Shteti.

Në bazë të kompetencave dhe në pajtueshmëri me Ligjin, AP ka të drejtë të kontrollojë të gjitha aktivitetet financiare, administrative dhe të tjera, programe dhe projekte të menaxhuara nga institucionet publike, përfshirë procesin dhe të ardhurat nga shitja e aseteve, privatizimeve dhe koncesioneve.

AP kryen auditime të rregullsisë⁴ së Buxhetit të Kosovës dhe të gjitha organizatave buxhetore, si dhe ndërmarrjeve publike. Gjithashtu, kryen auditime të performancës ose llojeve tjera të auditimeve, për të vlerësuar efikasitetin, efektivitetin dhe/ose ekonomikitetin e një aspekti të veçantë të operacioneve në tërësi ose të pjeshme të ndonjë institucioni, programi ose aktiviteti.

Neni 22 i Kushtetutës së Kosovës i bën të zbatueshme drejtpërdrejtë standardet ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik, si standardet e INTOSAI-t, Deklaratën e Limës dhe Deklaratën e Meksikës, të cilat mbështesin kryerjen e auditimeve nga Zyra Kombëtare e Auditimit. AP në përputhje me autorizimin kushtetues e ligjor, ka qasje të pakufizuar në të gjitha informatat dhe shpjegimet, që vlerëson se i nevojiten për qëllime të auditimit.

Disa ligje të veçanta kanë krijuar paqartësi për auditimin e disa institucioneve publike që çështjen e auditimit e kanë trajtuar në mënyrë tjetër krahasuar me dispozitat kushtetuese dhe ato të Ligjit për AP-në⁵. Ligji aktual për ZKA-në ka nevojë për ndryshim për sa i përket të drejtës së Ekzekutivit/Qeverisë për të modifikuar kërkesën buxhetore të ZKA-së⁶.

Në lidhje me këtë, AP-ja ka iniciuar ndryshimin e Ligjit që nga viti 2022. Ky ndryshim ka për qëllim përshtatjen e tij me standardet ndërkombëtare të institucioneve supreme të auditimit (SNISA). Projektligjin e propozuar Qeveria e ka vendosur në programin legjislativ për vitin 2024.

4 Auditimet e rregullsisë sipas SNISA-ve kanë kuptimin e Auditimeve financiare dhe të pajtueshmërisë.

5 Ligji Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Neni 63 dhe 73); Ligji Nr. 05/L-120 për Trepçën, Ligji Nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës (ndryshuar dhe plotësuar) dhe Ligji Nr. 03/L-063 për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë.

6 Në bazë të praktikave të mira ndërkombëtare (Deklarata e Limës dhe Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e ISA-ve) për të siguruar pavarësinë e plotë financiare, rekomandohet që buxheti i ISA-ve të trajtohet nga Kuvendi, jo nga Qeveria.

Ligji aktual edhe pse përcakton pavarësinë funksionale dhe operacionale, disa dispozita të ligjit nuk janë në përputhje me Kornizën e Deklaratave Profesionale të INTOSAI-t (Parimet dhe Standardet) kur bëhet fjalë për pavarësinë financiare.

AP në përputhje me autorizimin kushtetues e ligjor, ka qasje të pakufizuar në të gjitha informatat dhe shpjegimet, që vlerëson se i nevojiten për qëllime të auditimit.

Bazuar në Kushtetutë, AP-ja në mënyrë të pavarur raporton në Kuvend gjetjet e çdo viti, ku ka prezantuar para deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës Raportin Vjetor të Auditimit për vitin paraprak fiskal. Mbi këtë bazë, ka ftuar Kuvendin e Republikës së Kosovës që të kërkojë rritjen e përgjegjësisë llogaridhënëse nga institucionet e audituara në mënyrë që të ndërmerren veprime të menjëhershme për zbatimin e rekomandimeve dhe adresimin e mangësive të raportuara. Sikurse edhe gjatë viteve paraprake, ZKA-ja i ka bërë publike të gjitha raportet e auditimit.



**Qeverisja e brendshme
dhe etika**

Kapitull II - Qeverisja e brendshme dhe etika

Qeverisja e brendshme dhe etika, përfshinë treguesit si:

- Planin strategjik, operativ dhe planin vjetor;
- Mjedisin e kontrollit organizativ; dhe
- Komunikimin e brendshëm.

2.1. Planifikimi strategjik, operativ dhe plani vjetor


ZKA-ja zhvillon veprimtarinë e saj bazuar në planin strategjik, planin operativ dhe planin vjetor të auditimit.

- **Planifikimi strategjik** - Dokumenti i miratuar për periudhën 2023-2026 është në vitin e dytë të zbatimit. Rezultatet e arritura identifikohen përmes planit operativ, i cili shërben për monitorimin dhe raportimin e avancimit të Planit Strategjik. Si një mjet për të ndjekur realizimin e objektivave strategjike, është përgatitur një raport gjashtëmujor, si dhe një Raport Vjetor mbi zbatimin e planit të veprimit dhe monitorimit të Strategjisë për ZKA-në, për zbatimin e dokumentit të Strategjisë për periudhën janar 2024 deri në janar 2025.

Gjatë kësaj periudhe, ZKA ka realizuar të gjitha veprimet e nevojshme për përmbushjen e qëllimeve strategjike, përfshirë: realizimin e misionit të saj kushtetues dhe ligjor përmes kryerjes së auditimeve të rëndësishme në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit, rritjen e kapaciteteve institucionale për të siguruar auditime efektive, si dhe përmirësimin e bashkëpunimit me palët e interesit.

- **Plani operativ** - ZKA ka vazhduar me përmbushjen e objektivave strategjike në përputhje me planin operativ. Progresi në arritjen e objektivave strategjike të përfshira në 60 aktivitete është si vijon:

60 aktivitete të planifikuara



Mos përmbushja e aktiviteteve është për shkak të nevojës për bashkëpunim me palët e jashtme, miratimit të ligjit të ZKA-së dhe mekanizmit që përfshin shqyrtimin e raporteve të auditimit të ZKA-së gjatë dëgjimeve buxhetore të organizatave në procesin e hartimit të ligjit për buxhetin.

- **Plani vjetor i auditimit** - AP-ja ka miratuar Planin Vjetor të Auditimit 2024/2025, i cili përfshin sezonin e auditimit nga 1 shtatori 2024 deri 31 gusht 2025. ZKA përgatit çdo vit këtë plan, i cili ofron informacione mbi objektivat e saj, llojet e auditimeve, procesin e auditimit, organizimin, buxhetin dhe shpërndarjen e burimeve njerëzore, si dhe auditimet e projekteve. Gjatë përgatitjes së Planit Vjetor të Auditimit, janë marrë parasysh përmbushja e detyrimeve kushtetuese dhe ligjore për auditime të rregullsisë, mbulueshmëria sa më e gjerë me auditime të performancës dhe rëndësia e çështjeve aktuale. Planifikimi i këtyre auditimeve është bërë duke pasur parasysh kapacitetet njerëzore dhe financiare që ZKA ka pasur në dispozicion. Në përputhje me kërkesat ligjore, plani është dorëzuar në Komisionin për Menaxhimin e Financave Publike (KMFP) me 28 tetor 2024.

2.2. Mjedisi i kontrollit organizativ

Në përputhje me kërkesat e ligjit, rregulloreve të brendshme dhe SNISA-ve, ZKA-ja ka ndërtuar një strukturë organizative të përshtatshme, e cila mbështet krijimin e një sistemi të kontrollit të brendshëm. Ky sistem ofron një siguri të arsyeshme se operacionet e institucionit menaxhohen në mënyrë efikase dhe efektive.

- **Kodi i Etikës së ZKA-së** - rishikohet rregullisht dhe është në përputhje të plotë me Kodin e Etikës së INTOSAI-t. Ky dokument përfshin rregullime të rëndësishme mbi integritetin, pavarësinë, objektivitetin, kompetencën profesionale, konfidencialitetin dhe menaxhimin e konflikteve të interesit. Kodi është i detyrueshëm për të gjithë punonjësit e ZKA-së.

ZKA ka organizuar trajnime për stafin e saj dhe ka përgatitur procedura të dokumentuara që kërkojnë nga i gjithë personeli, si dhe nga palët e autorizuara për të kryer veprimtari për ZKA-në, që të bien dakord me standardet etike, duke nënshkruar dhe respektuar Kodin e Etikës dhe Deklaratën e Pavarësisë Profesionale. Brenda ZKA-së funksionon Komisioni për Çështje Etike, i cili monitoron zbatimin e Kodit të Etikës dhe jep rekomandime për çdo rast apo kërkesë që lidhet me çështjet etike nga ana e stafit.

- **Sistemi i kontrollit të brendshëm** - Kontrolli i brendshëm për aktivitetet jo audituese kryhet nëpërmjet rregullave dhe procedurave të menaxhimit financiar dhe kontrollit. Në ZKA zbatohet: ndarja e detyrave, delegimi, autorizimi, mbikëqyrja dhe auditimi i brendshëm. ZKA ka përgatitur një dokument të dedikuar për menaxhimin e rreziqeve, i cili zbatohet duke u mbështetur në objektivat e përcaktuara nga dokumentet e saj strategjike dhe nga korniza e aplikueshme për menaxhimin financiar dhe kontrollin (MFK). Gjithashtu, ZKA ka zhvilluar një strukturë funksionale të mirë të kontrolleve të brendshme. Të gjitha komponentët e këtyre kontrolleve veprojnë në mënyrë efikase, duke përfshirë edhe procesin e vlerësimit të rreziqeve.

- **Auditimi i brendshëm** - ZKA funksionon me një auditor të brendshëm (AB) që është udhëheqës i njësisë dhe raporton drejtpërdrejt te Auditori i Përgjithshëm (AP). Për planifikimin e aktiviteteve të auditimit, përdoret një metodologji e bazuar në rrezik, me qëllim që t'i ofrohet siguri AP-së se proceset e menaxhimit të rrezikut, qeverisjes dhe kontrollit të brendshëm në ZKA funksionojnë në mënyrë efikase. Në vitin 2024, AB ka kryer katër raporte auditimi me temat: "Procesi i Rekrutimit në ZKA", "Menaxhimi i Shpenzimeve dhe Procesi i Buxhetimit në ZKA", "Qeverisja e Teknologjisë Informative" dhe "Aktivitetet e Prokurimit". Komiteti i Auditimit (KA) si një komponent kyç i strukturës së qeverisjes në ZKA, kryen funksionin e tij në përputhje me rregullativën në fuqi. KA gjatë vitit 2024 ka mbajtur katër takime, si dhe ka hartuar raportin vjetor, në të cilat janë shqyrtuar raportet e AB-së dhe opinioni i auditorit të jashtëm për PFV e vitit paraprak.

2.3. Komunikimi i brendshëm

Komunikimi i brendshëm efektiv u mundëson punonjësve të ZKA-së, në të gjitha nivelet, të koordinojnë kërkesat dhe propozimet e ndryshme lidhur me çështjet audituese dhe ato administrative brenda institucionit.

Menaxhmenti i ZKA-së zhvillon takime javore të rregullta, të cilat dokumentohen me procesverbale. Vendimet e marra regjistrohen dhe komunikohen stafit në varësi të rëndësisë së tyre dhe nevojës për transparencë. Këto dokumente janë të qasshme për të gjitha nivelet e organizatës. Po ashtu, ekziston një mekanizëm për shpërndarjen e informacionit nëpërmjet rrjetit të brendshëm të komunikimit elektronik, ku menaxhmenti i ZKA-së informon rregullisht punonjësit mbi çështjet kryesore që lidhen me organizatën.

Niveli i mesëm drejtues raporton rregullisht te menaxhmenti mbi aktivitetet e zhvilluara. Procesi i audituar dokumentohet dhe raportohet përmes organizimit dhe mirëmbajtjes së dosjeve përkatëse, si dhe përmes sistemit informativ për menaxhimin e auditimeve (SITA). Kjo ka kontribuar në rritjen e transparencës dhe në përmirësimin e kontrollit të cilësisë në realizimin e funksionit auditues.

Në qershor të vitit 2024 është miratuar Udhëzuesi për Komunikim në Zyrën Kombëtare të Auditimit i cili synon të sigurojë se komunikimi institucional është i koordinuar dhe menaxhuar në mënyrë efektive dhe të përgjegjshme për nevoja organizative dhe funksionale. Ky Udhëzues promovon misionin, vizionin dhe vlerat e institucionit përmes informimit dhe bashkëpunimit të vazhdueshëm.

03

**Planifikimi, realizimi dhe
cilësia e auditimeve**

Kapitulli III – Planifikimi, realizimi dhe cilësia e auditimeve

Komponentët që trajtohen në këtë kapitull janë: planifikimi, realizimi dhe cilësia e auditimeve, raportimi i rezultateve të auditimeve, adresimi i rekomandimeve nga subjektet e audituara, si dhe kontrolli i cilësisë.

3.1. Auditimet e planifikuara për sezonin e auditimit 2024/2025

Në Planin Vjetor të Auditimit, për sezonin e auditimit 2024/25, ZKA-ja planifikon të kryejë dhe të publikojë 139 auditime. Plani auditues përfshin llojet e auditimeve të paraqitura në tabelë.

Tabela 1. Numri dhe llojet e auditimeve të planifikuara për sezonën audituese 2024/2025

Llojet e auditimeve	Sezoni i auditimit /plani vjetor 2024/2025
Auditime të rregullsisë	108
Buxheti i Kosovës	1
Institucionet Qendrore	49 ⁷
Komunat	38
Ndërmarrjet Publike	12
Projekte	8
Auditimet e performancës	17
Performancë	5
Prokurim	5
Teknologji Informative	3
Performancë vazhdim nga viti paraprak	4
Auditime të pajtueshmërisë	11
Pajtueshmëri	11
Auditime të klasifikuara	3
Klasifikuara	3
Gjithsej	139

Për sezonin auditues 2024/25, përveç auditimeve financiare dhe pajtueshmërisë (auditime mandatore) të 87 OB-ve (plus auditimit të RVA-së), do të kryhen 12 auditime të NP, si dhe 8 të projekte të financuara nga Banka Botërore.

7 Është themeluar Agjencia për Mbrojtjen e Informacionit të Klasifikuar.

Përveç auditimeve të detyrueshme të rregullsisë (financiar dhe pajtueshmërisë) të përcaktuar me ligj, fokus i veçantë i është dhënë ndërmarrjeve publike të cilat janë vlerësuar si më komplekse siç janë: KEK, Trepça, KOSTT, NPB dhe projekte kapitale me peshë të lartë financiare.

Në krahasim me vitin e kaluar, kemi ulur kontraktimin e institucioneve të pavarura prej 12 në 10 të kontraktuara, përderisa te komunat është numri i njëjtë me 10 auditime të kontraktuara. Këto auditime do të përkrahen nga një kompani private e auditimit, përderisa opinioni i auditimit përcaktohet nga Auditori i Përgjithshëm bazuar në metodologjinë e ZKA-së dhe në përputhje me SNISA-t. Kontraktimi i auditimeve ka ndodh për shkak të largimit (dorëheqjeve) të stafit profesionist nga puna, kryesisht për shkak të pagave jo të konkurrueshme për këtë profesion. Arsye tjetër është fokusimi i angazhimit të kapaciteteve njerëzore në dispozicion në fushat me rrezik të lartë. Po ashtu këtë vit është rritur vëllimi i punës për burimet në dispozicion ku janë planifikuar 11 auditime të pajtueshmërisë.

Vlen të theksohet se ZKA ka krijuar mekanizma të brendshëm në trajtimin e kërkesave të ndryshme që vijnë nga palët e jashtme për auditime me kërkesë, dhe si të tilla janë trajtuar në mënyrën më efektive.

3.2. Auditimet e realizuara në vitin 2024

ZKA ka publikuar gjithsej 127 raporte të auditimi gjatë vitit 2024, si në tabelën në vijim:

Tabela 2. Numri dhe llojet e auditimeve të realizuara në vitin 2024

Llojet e auditimeve	Auditimet e realizuara 2024
Auditime financiare dhe të pajtueshmërisë	108
Buxheti i Kosovës	1
Institucionet qendrore	48
Komunat	38
Ndërmarrjet publike	12
Projekte	9
Auditimet e performancës	14
Performancë dhe prokurim	9
Teknologji informative	5
Auditime të pajtueshmërisë	2
Auditime me nivel të informacionit të klasifikuar.	3
Gjithsej	127

Në kuadër të auditimeve të performancës dhe pajtueshmërisë janë përfshirë auditime të kryera me kërkesë të Kuvendit të Kosovës dhe Qeverisë.

ZKA ka përmbushur mandatin duke mbuluar me auditimet financiare dhe të pajtueshmërisë të gjitha organizatat buxhetore përfshirë RTK-në e cila ka status të veçantë por e cila financohet përmes buxhetit të Kosovës, poashtu edhe auditime të performancës dhe të pajtueshmërisë.

3.3. Cilësia e auditimit dhe raportimi

ZKA kryen auditimet në pajtueshmëri me SNISA-t dhe praktikat e mira. Po ashtu, për të siguruar cilësinë e auditimeve ka të hartuar doracakët e auditimit financiar me qasje të kombinuar me pajtueshmëri, doracakun për pajtueshmëri, doracakun për auditime të performancës dhe prokurimit si dhe doracakun për auditime të teknologjisë së informacionit. Për të siguruar se cikli i llogaridhënies lidhur me cilësinë në auditim përmbyllet siç duhet, ka të hartuar edhe udhëzuesin për menaxhimin e cilësisë në auditim.

Në përputhje me mandatin ligjor dhe fushëveprimin, ZKA kryen këto lloje të auditimeve:

- Auditime financiare dhe të pajtueshmërisë⁸ të organizatave buxhetore dhe të ndërmarrjeve publike;
- Auditime të performancës (prokurimit dhe teknologjisë së informacionit) dhe
- Auditime të pajtueshmërisë.
- **Auditimi Financiar dhe i Pajtueshmërisë** - përfshinë auditimin e PFV-ve të institucionit me qëllim të vlerësimit nëse raportet financiare:
 - janë të besueshme dhe pasqyrojnë rezultatet e realizimit të buxhetit në mënyrë të drejtë;
 - vlerësimin nëse menaxhmenti iu ka përmbajtur ligjeve dhe akteve nënligjore të zbatueshme dhe nëse fondet janë përdorur për qëllimet e synuara;
 - vlerësimin e funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar, funksionet e auditimit të brendshëm dhe sistemet e kontrollit të brendshëm.

Objektivat e auditimit financiar dhe të pajtueshmërisë përkufizohen si siguri e arsyeshme, e cila i ofrohet shfrytëzuesve të pasqyrave financiare, nëse informatat në pasqyrat financiare të audituara janë në kuptimin material të vërteta dhe të drejta dhe nëse transaksionet e raportuara në ato pasqyra janë kryer në pajtueshmëri me autoritetet⁹.

Qëllimi gjithëpërfshirës i auditimit financiar dhe i pajtueshmërisë është të rritet niveli i besueshmërisë së përdoruesve të synuar të Pasqyrave Financiare Vjetore dhe përdorimi i fondeve publike në pajtueshmëri me autoritetet.

Auditimet financiare dhe pajtueshmërisë kryhen çdo vit. Procesi i auditimit fillon në shtator, ndërsa raportet e auditimit për OB-të individuale publikohen deri në fund të muajit qershor. Cikli i auditimeve përmbyllet në fund të muajit gusht kur Raporti Vjetor i Auditimit (RVA) për Raportin Financiar Vjetor të Buxhetit të Kosovës (RFV/BK) dorëzohet në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

8 Ky është emërtimi i shprehjes - auditim i rregullsisë.

9 "Pajtueshmëri me autoritetet" do të thotë është pajtueshmëri me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira.

- **Auditimet e performancës** - paraqesin një shqyrtim të pavarur, objektiv dhe të besueshëm nëse angazhimet qeveritare, sistemet, operacionet, programet, aktivitetet ose organizatat janë duke vepruar në përputhje me parimet e ekonomicitetit (minimizimi i kostove të burimeve), efikasitetit (përfitimi sa më shumë nga burimet në dispozicion) dhe efektivitetit (përmbytja e objektivave të përcaktuara dhe rezultateve të synuara). Fushat, objektivat dhe koha e auditimit dhe e raportimit përcaktohen prej rastit në rast, duke u bazuar në rëndësinë, rrezikun, fushëveprimin e auditimit, kapacitetet ekzistuese si dhe kriteret tjera përkatëse.

Auditimi i performancës fokusohet në atë se si organizatat e sektorit publik i kanë përdorur burimet në dispozicion për t'i arritur objektivat e tyre. Për ekzaminimin e performancës së entitetit të audituar, ZKA ndjek një rën nga tri qasjet: qasjen e orientuar në rezultate, qasjen e orientuar në problem dhe qasjen e orientuar në sistem, ose një kombinim të qasjeve.

- **Auditimet e teknologjisë së informacionit (TI)** - pasqyrojnë vlerësimin dhe rishikimin e sistemeve të TI-së dhe kontrollet e ndërlidhura me to, për të përfutur siguri ose për të identifikuar rreziqet lidhur me parimet e ligjshmërisë, efikasitetit, ekonomicitetit dhe efektivitetit të sistemeve të TI-së.
- **Auditimet e pajtueshmërisë** - janë vlerësime të pavarura nëse lënda e caktuar është në pajtueshmëri me autoritetet e zbatueshme, të identifikuar si kritere. Auditimet e pajtueshmërisë kryhen duke vlerësuar nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacioni janë në pajtim, në të gjitha aspektet materiale, me autoritetet që qeverisë entiteti i audituar¹⁰.

3.4. Rezultatet e auditimit dhe adresimi i rekomandimeve të auditimit financiar dhe të pajtueshmërisë

Raporti Vjetor i Auditimit (RVA) për Pasqyrat Financiare Vjetore të Buxhetit të Republikës së Kosovës të vitit 2023 është dorëzuar në Kuvendin e Kosovës brenda afatit ligjor në gusht të vitit 2024.

Përmbledhje të mangësive të identifikuara në raportet e auditimit për vitin 2023

- **Organizatave buxhetore** - Cilësia e raportimit financiar ende vazhdon të mos jetë në nivelin e pritshëm për shkak se nga 86 auditimet e pasqyrave vjetore financiare të organizatave buxhetore 35 prej tyre kishin keqdeklarime materiale, të cilat kanë rezultuar me opinion të modifikuar/kualifikuar. Ndërsa, 51 të tjera kanë rezultuar me opinion të pamodifikuar.

Duhet theksuar se në nivelin qendror ka një përmirësim në lidhje me raportimin financiar, ku në vitin 2023 janë 12 OB me opinione të modifikuara ndërsa në vitin paraprak ishin 17 me opinione të modifikuara, ndërsa tek niveli lokal në vitin 2023 ka 23 opinione të modifikuara që krahasuar me vitin paraprak ishin vetëm 16 opinione të modifikuara, që tregon një gjendje jo të mirë sa i përket raportimit financiar.

Po ashtu, në lidhje me pajtueshmërinë nëse aktivitetet dhe transaksionet po kryhen në pajtim me kornizën ligjore gjendja ishte jo e mirë sidomos te niveli lokal. Në vitin 2023 nga 86 OB-të e audituara 37 kishin konkluzion të pamodifikuar kurse 49 e kishin konkluzionin e modifikuar. Te

¹⁰ SNISA 400.12

niveli lokal, prej 38 komunave, 35 e kishin konkluzionin e modifikuar, përderisa te niveli qendror, prej 48 OB-ve të audituara, 14 ishin me konkluzionin e modifikuar. Në raport me vitin paraprak gjendja është pothuajse e njëjtë.

- Ndërmarrjet Publike** - Cilësia e raportimit financiar edhe pse krahasuar me vitin e kaluar është përmirësuar, megjithatë edhe te ndërmarrjet publike ende vazhdon të mos jetë në nivelin e pritur. Nga 12 auditimet e pasqyrave financiare të ndërmarrjeve publike, për tri NP është dhënë opinion i pamodifikuar, ndërsa për nëntë të tjera opinion i modifikuar (pesë opinione të kualifikuara dhe katër të kundërta). Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli në ndërmarrjet publike ka nevojë për përmirësime të mëtejme, marrë parasysh që në nëntë prej tyre pasqyrat financiare për 2023 përmbanin keqdeklarime materiale. Po ashtu, sa i përket pajtueshmërisë me ligjet dhe rregulloret në fuqi, krahasuar me vitin paraprak, dy ndërmarrje kanë bërë progres duke kryer aktivitetet dhe transaksionet e tyre në pajtim me kornizën ligjore, ndërsa ndërmarrjet tjera në raste të caktuara nuk kishin kryer transaksionet dhe aktivitetet në pajtueshmëri me ligjet dhe rregulloret në fuqi. Ndërsa, sa i përket performancës financiare, tetë prej tyre kanë operuar me fitim, ndërsa katër tjerat kanë operuar me humbje.
- Auditimet e Performancës** - Auditimet e kryera gjatë vitit 2024, kanë identifikuar mangësi në fusha me rëndësi ekonomike, shëndetësore, të mirëqenies sociale dhe prokurimit publik, që tregojnë për mungesën e efikasitetit, llogaridhënies, efektivitetit dhe mos arritjen e vlerës për parane e shpenzuar dhe shërbimeve ndaj qytetarëve. Shërbimet publike në Kosovë përballen me sfida si në efikasitet ashtu edhe në efektivitet. Auditimet kanë nxjerr në pah joefikasitet në shërbimet shëndetësore, koha e pritjes së pacientëve në klinika, veçanërisht në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK), ka raste që është mbi katër vite. Përveç kësaj, programet për integrimin e grave rurale në tregun e punës nuk kanë arritur rezultate të kënaqshme. Shqetësimet e mëtejshme përfshijnë llogaridhënien dhe transparencën. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dështoi të mbajë përgjegjës organizatat të cilat i financon dhe ato që përfitojnë vërtetim sponsorizimi nga bizneset private. Në mënyrë të ngjashme, Administrata Tatimore nuk ka arritur t'i identifikoj dhe të ndërmarrë masat ligjore ndaj kompanive të cilat janë liruar nga tatimi për sponsorizim dhe të cilat nuk i kanë dhënë fondet për sponsorizim. Auditimet evidentuan edhe mangësi në licencimin e mediave, ku disa media operojnë pa përmbushur detyrimet e tarifës vjetore. Për më tepër, menaxhimi i parkingjeve publike është karakterizuar me mungesë të planifikimit dhe lëshim i lejeve të parkingut pa dokumentacionin e duhur. Këta shembuj ngrenë shqetësime në lidhje me efektivitetin e mekanizmave të mbikëqyrjes dhe të zbatimit brenda organizatave apo institucioneve publike. Gjatë përmbylljes së shitjeve direkte të aseteve, Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) nuk ishte efikase, pasi kërkesat për blerje nuk u trajtuan në kohë optimale. Në fushën e TI-së institucionet përgjegjëse nuk kanë bërë veprime të mjaftueshme për të siguruar menaxhim të mirë të projekteve dhe ka mangësi në shtrirjen dhe përdorimin e sistemit dhe sigurinë e të dhënave. Ministria e Arsimit Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit, ka dështuar për të menaxhuar dhe zbatuar projektin e teknologjisë së informacionit për digjitalizimin e procesit mësimor dhe të testimit/ vlerësimit të maturës. Ministria e Shëndetësisë nuk ka arritur të zbatoj Sistemin e Menaxhimit të Stokut Farmaceutik i cili nuk përdoret nga të gjitha barnatoret e niveleve të ndryshme shëndetësore deri në shpërndarjen e barnave tek pacientët si dhe nuk ka ndërmarrë veprime të duhura rreth sigurisë së informacionit për këtë sistem. Ndërsa auditimi paralel me institucionin homolog - Kontrollin e Lartë të Shtetit të Shqipërisë i kryer në Ujësjellësin Rajonal të Prishtinës dhe Tiranës, nxjerr në pah mangësi të theksuara në qeverisjen e TI-së, sigurinë e informacionit dhe vazhdimësinë e shërbimeve në të dy kompanitë e ujësjellësit.


- **Zbatimi i rekomandimeve** - Raportet e auditimit për vitin 2023 kanë rezultuar me gjithsej 817 gjetje dhe rekomandime për adresimin e tyre. Prej tyre 548 rekomandime janë dhënë për OB mandatore (*niveli qendror, niveli lokal dhe institucione të pavarura*), përderisa 133 janë për ndërmarrje publike, 124¹¹ janë për auditime të performancës dhe 12 janë për auditime të pajtueshmërisë. Nga gjithsej 817 rekomandimet e dhëna, 440 janë rekomandime të reja, 320 të përsëritura dhe 57 rekomandime pjesërisht të përsëritura.

Niveli i zbatimit të rekomandimeve të dhëna ende vazhdon të mbetet i ulët. Në auditimet individuale për organizatat buxhetore (*niveli qendror, niveli lokal dhe institucione të pavarura*) dhe ndërmarrje publike në vitin paraprak ishin 743 rekomandime, ku është vlerësuar se 46% e rekomandimeve të dhëna të vitit paraprak janë zbatuar plotësisht, me një nivel më të ulët të zbatimit për 3%, krahasuar me vitin paraprak, ku ishte vlerësuar zbatimi i rekomandimeve me 49%.

- **Konkluzioni i përgjithshëm** është se ndikimi i punës së ZKA-së ishte përmirësimi i menaxhimit të pasurisë dhe pasurisë publike me efekt pozitiv në disa fusha. Përmirësimet janë vërejtur te cilësia e raportimit financiar, regjistrimi dhe menaxhimi i pasurisë publike, dhe te regjistrimi i drejtë i detyrimeve kontingjente. Te ndërmarrjet publike zbatimi i rekomandimeve ka pasur ndikim pozitiv në përgatitjen e pasqyrave financiare dhe raportin vjetor brenda afatit kohor, prezantimin e saktë të detyrimeve kontingjente, përditësimin e kontratave të punës, hartimin e rregulloreve të brendshme për menaxhimin e aktiviteteve në ndërmarrje etj.

ZKA ka audituar 86 OB dhe 12 Ndërmarrje Publike për vitin fiskal 2023. Rezultati përcjellës dhe analizimi i progresit në zbatimin e rekomandimeve është paraqitur më poshtë:

Grafiku 1. Numri i rekomandimeve të dhëna në raportet individuale të OB dhe NP në tri vite



11 Ky është numri i rekomandimeve sipas RVA-së, ndërsa deri në fundvit, janë 126 rekomandime të performancës.

12 Në këtë numër janë përfshirë edhe 20 rekomandime të dhëna në raportet e auditimit për vitin 2021, për komunat: Mitrovica Veriore, Zveçani, Leposaviqi dhe Zubin Potoku, për arsye se në këto kumuna nuk është kryer auditimi për vitin 2022. Kështu që vlerësimi i zbatimit të rekomandimeve të dhëna është për 372 rekomandime.

Të dhënat tregojnë një trend ulje të numrit të rekomandimeve krahasuar me vitet paraprake tek niveli qendror dhe ndërmarrjet publike, përderisa te niveli lokal është një rritje e lehtë e rekomandimeve krahasuar me vitin paraprak (këtë vit janë audituar katër komunat veriore të cilat nuk janë audituar vitin e kaluar). Në 681 rekomandimet e dhëna për vitin 2023, prej tyre 304 janë rekomandime të reja, 320 janë rekomandime të përsëritura dhe 57 rekomandime janë pjesërisht të përsëritura.

Tabela 3. Progresi i zbatimit të rekomandimeve në vitin 2023 nga viti paraprak në OB dhe NP


Auditimet sipas fushave	Rekomandimet	Rekomandimet që nuk janë të aplikueshme	Rekomandimet për zbatim	Të zbatuara, me %		Të adresuara pjesërisht apo në proces, me %		Të pazbatuara, me %	
Institucionet e nivelit qendror	166	11	155	76	49%	21	11%	58	40%
Institucionet e pavarura	53	1	52	31	72%	5	6%	16	22%
Institucionet e nivelit lokal	372	12	360	140	46%	19	8%	201	46%
Ndërmarrjet Publike	152	15	137	79	58%	10	7%	48	35%
Gjithsej	743	39	704	326	46%	55	8%	323	46%

Në raportet e auditimit të vitit paraprak për OB mandatore (institucione qendrore, institucione lokale-komuna dhe institucione të pavarura) dhe NP, janë dhënë 743 rekomandime (prej tyre 39 nuk janë të aplikueshme) dhe gjatë auditimit për vitin 2023 është vlerësuar zbatimi i 704 rekomandimeve.

Sipas këtij vlerësimi, 46% e rekomandimeve ishin zbatuar plotësisht, 8% ishin zbatuar pjesërisht dhe 46% nuk janë zbatuar.

Po ashtu deri në fund vitin 2024, janë kryer 14 auditime të performancës dhe 5 auditime të pajtueshmërisë (prej tyre 3 auditime me nivel të informatave të klasifikuara) për vitin fiskal 2023.

Grafiku 2. Numri i rekomandimeve të dhëna në raportet e performancës dhe raportet e pajtueshmërisë



3.5. Auditimet e performancës

Zyra Kombëtare e Auditimit gjatë vitit 2024 ka kryer 14 auditime të performancës, prokurimit dhe teknologjisë së informacionit. Këto auditime kanë mbuluar fusha me interes për qytetarët, Kuvendin e Kosovës dhe palët e tjera të interesit, me fokus në: shëndetësi, zhvillim ekonomik dhe buxhet, ekonomi, prokurim publik, mirëqenie ekonomike/sociale, menaxhim i proceseve, si dhe teknologji të informacionit. Në fushën e mirëqenies ekonomike/sociale-barazisë gjinore, është kryer edhe një auditim i përbashkët ndërmjet institucioneve të auditimit të Shqipërisë, Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut.

Auditimet e publikuara sipas fushave në auditimet e performancës, prokurimit dhe TI-së janë:



Shëndetësi:

1. Lista e pritjes së pacientëve në Institucionet Shëndetësore Publike;



Zhvillim ekonomik dhe buxhet:

1. Procesi i Dokumentimit, Vlerësimit dhe Verifikimit në Sistemin për Menaxhimin e Performancës Komunale për vitin 2020;
2. Mekanizmat e sigurimit të cilësisë së të dhënave të raportuara për Sistemin e Menaxhimit të Performancës Komunale dhe Grantin e Performancës Komunale për vitin 2021;
3. Vlerësimi i Procedurave të Shitjes Direkte të Aseteve nën menaxhimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit;



Ekonomi:

1. Menaxhimi i tokave/pronës nga Instituti Bujqësor i Kosovës;
2. Menaxhimi i licencimeve në Komisionin e Pavarur për Media;

13 Deri në fundvit 2024 janë gjithsej 126 rekomandime të performancës



Prokurim publik:

1. Efektiviteti dhe efikasiteti i kontraktimit të shërbimeve Shëndetësore dhe sociale nga institucionet e Republikës së Kosovës;



Mirëqenie ekonomike/sociale:

1. Menaxhimi i parkingjeve publike në qytetin e Prishtinës nga Ndërmarrja Publike Lokale Prishtina Parking;
2. Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave nga zonat rurale përmes përfshirjes së tyre në tregun e punës;
3. Auditim Paralel me KLSH dhe ESHRRMV (Maqedoni e Veriut) Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave nga zonat rurale nëpërmjet përfshirjes së tyre në tregun e punës;



Arsim dhe kulturë:

1. Efektiviteti i fondeve për financimin e sportit;



Teknologji të informacionit:

1. Modernizimi i Sistemit të Edukimit në Kosovë përmes e-Edukimit;
2. Sistemi Informativ për Menaxhimin e Stokut Farmaceutik;
3. Sistemet e Informacionit në Doganën e Kosovës - ASYCUDA World.

Në këto auditime ZKA-ja ka përfshirë 44 organizata, prej tyre 10 Ministri, 13 Komuna, 9 Spitale Rajonale, 7 Agjenci si dhe 4 organizata tjera dhe Zyra e Kryeministrit. Për organizatat e audituara janë dhënë 126 rekomandime, ku dy prej këtyre rekomandimeve janë dhënë për Qeverinë e Kosovës me qëllim të adresimit më të shpejt/urgjent të disa çështjeve.

Më poshtë paraqesim entitetet, numrin e rekomandimeve dhe mesazhin e dhënë për auditimet e publikuara të performancës:

1. Lista e pritjes së pacientëve në Institucionet Shëndetësore Publike:

- **Entitetet e përfshira në auditim janë:** Ministria e Shëndetësisë, Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës, Qendra Klinike dhe Universitare e Kosovës, shtatë spitale Rajonale: Prizren, Pejë, Gjakovë, Gjiilan, Mitrovicë, Ferizaj dhe Vushtrri,
- **Mesazhi i auditimit:** Ministria e Shëndetësisë dhe Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar nuk kishin ndërmarrë masa të mjaftueshme për të siguruar trajtimin efikas të pacientëve në listat e pritjes, ka shpërndarje jo të barabartë të burimeve njerëzore dhe materiale në sektorë të caktuar shëndetësor dhe mënyra aktuale e regjistrimit të pacientëve në listat e pritjes nuk siguron transparencë, saktësi dhe trajtim të drejtë të pacientëve, ku janë dhënë 13 rekomandime.

2. Procesi i Dokumentimit, Vlerësimit dhe Verifikimit në Sistemin për Menaxhimin e Performancës Komunale për vitin 2020:

- **Entitetet e përfshira në auditim janë:** Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe katër komuna: Obiliq, Gjiilan, Skenderaj dhe Graçanicë.
- **Mesazhi i auditimit:** Komunitet e audituara në përgjithësi nuk kanë dokumentuar treguesit e performancës komunale me dokumente mbështetëse. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal kishte kryer vlerësimin, megjithatë nuk ka respektuar të gjitha rregullat e vlerësimit, sidomos kërkesën lidhur me verifikimin fizik në terren. Një vlerësim ad hoc i treguesve në terren nga Ministria është kryer pas vlerësimit të performancës komunale, mirëpo me të gjitha mangësitë e identifikuara ky vlerësim nuk ka ndikuar në rezultat në renditjen finale të komunave përfituese. Mangësitë ekzistuese në Sistemin e Menaxhimit të Performancës Komunale zbehin besueshmërinë e përzgjedhjes së përfituesve dhe dekurajon komunitet që t'i përgjigjen në mënyrë efektive kërkesave të këtij sistemi, ku janë dhënë 7 rekomandime.

3. Mekanizmat e sigurimit të cilësisë së të dhënave të raportuara për Sistemin e Menaxhimit të Performancës Komunale dhe Grantin e Performancës Komunale për vitin 2021:

- **Entitetet e përfshira në auditim janë:** Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe tri komuna: Gjakovë, Viti dhe Klinë.
- **Mesazhi i auditimit:** Ministria nuk ka siguruar kontrolle efektive për menaxhimin e performancës komunale, sepse nuk ka arritur të kryej vlerësime paraprake, pranimi i dokumenteve të pa protokolluara dhe mospërputhjet në pikët e dhëna kanë komprometuar efektivitetin e mekanizmave që synojnë të sigurojnë cilësi në raportimin e performancës komunale. Këto të meta, kanë ndikuar në renditje jo të drejtë të komunave të audituara.

Gjithashtu cilësia e raportimit të performancës komunale nuk është në nivel të duhur. Mangësitë në komunikim, proceset e miratimit dhe shpërndarjen e detyrave i kanë bërë mekanizmat e kontrollit për sigurimin e cilësisë të paefektshëm. Mungesa e dëshmimeve të komunikimit dhe miratimit nga zyrtarët përgjegjës rrezikon besueshmërinë e të dhënave të raportuara, ku janë dhënë 11 rekomandime.

4. Vlerësimi i Procedurave të Shitjes Direkte të Aseteve nën menaxhimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit:

- **Entitetet e përfshira në auditim janë:** Agjencia Kosovare e Privatizimit.
- **Mesazhi i auditimit:** Agjencia Kosovare e Privatizimit nuk ishte treguar efikase në përmbylljen e shitjeve direkte të asetëve pasi që trajtimi i kërkesave për blerje nuk ishte bërë në kohë optimale. Dobësi kishe edhe procesi i kategorizimit të asetëve të klasifikuara për shitje direkte, nuk ishte bërë parcelimi si duhet i tokave për shitje dhe në vitet e fundit kategoria e vetme të cilës i ishin shqyrtuar kërkesat për blerje ishin ekonomitë familjare (persona fizik). Ndërsa në përzgjedhjen e vlerësuesve, ne nuk kemi vërejtur ndonjë dobësi, përveç që nuk kishte metodologji të përcaktuar për përzgjedhjen e tyre por që praktika e zbatuar ndër vite është inkorporuar më vonë në rregullore, ku janë dhënë 7 rekomandime.

5. Menaxhimi i tokave/pronës nga Instituti Bujqësor i Kosovës:

- **Entitetet e përfshira në auditim janë:** Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural/Instituti Bujqësor i Kosovës, Agjencia Kadastrale e Kosovës dhe Komuna e Pejës.

- **Mesazhi i auditimit:** Ministria dhe Instituti nuk kanë arritur t'i menaxhojnë si duhet tokat bujqësore të Institutit. Ka mungesë të qartë të bazës ligjore për Institutin, Bordi Menaxhues nuk ka funksionuar duke ndikuar që Instituti të mos ketë menaxhim të duhur dhe politika drejtuese për zhvillimin e aktivitetit të Institutit. Janë mbi 309 hektar tokë bujqësore të Institutit që nuk menaxhohen në mënyrën e duhur, prej tyre mbi 52ha shfrytëzohen në mënyrë të pa autorizuar dhe rreth 31ha të tjera janë tjetërsuar pa njohurinë/pëlqimin e Institutit. Instituti për nevojat hulumtuese shfrytëzon vetëm 5ha ndërsa rreth 260ha i ka ofruar/dhënë me qira por të cilat nuk janë menaxhuar në mënyrën e duhur, ku janë dhënë 8 rekomandime.

6. Menaxhimi i licencimeve në Komisionin e Pavarur për Media:

- **Entitetet e përfshira në auditim janë: Komisioni i Pavarur i Mediave.**
- **Mesazhi i auditimit:** Procesi i menaxhimit të licencave të Ofruesve të Shërbimeve nga Komisioni i Pavarur për Media është karakterizuar me dobësi duke ndikuar që kriteret për aktivitetet mediatike të mos zbatohen. Mediat veprojnë pa përmbushur obligimet financiare të tarifave vjetore përgjatë viteve dhe pezullimet e licencave të mediave nuk realizohen nga Komisioni i Pavarur i Mediave ku për pasojë kemi grumbullim të borxheve. Operatorët e shpërndarjes dhe ofruesit e shërbimeve mediale audio dhe audiovizuale të mediave janë licencuar pa plotësuar kriteret. Mbledhja e borxheve nga mediat dhe pezullimet-revokimet e licencave të tyre nuk janë realizuar me kohë dhe në mënyrën e duhur nga Komisioni i Pavarur për Media, ku janë dhënë 5 rekomandime.

7. Efektiviteti dhe efikasiteti i kontraktimit të shërbimeve Shëndetësore dhe sociale nga institucionet e Republikës së Kosovës:

- **Entitetet e përfshira në auditim janë:** Zyra për Komunitete, në kuadër të Zyrës së Kryeministrit Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe pesë komuna: Ferizaj, Fushë Kosovë, Shtime, Obiliq dhe Prizren.
- **Mesazhi i auditimit:** Kishte nevojë për të kontraktuar shërbime shëndetësore dhe sociale shtesë, për shkak të pandemisë si dhe rritjes së kërkesave për shërbime shëndetësore si rezultat i rritjes së popullsisë në komunat e audituara. Megjithatë kishte mangësi në procese duke filluar nga vlerësimi jo-real i nevojave për shërbime shtesë, përdorimi i procedurave të ndryshme pa arsytim të qëndrueshëm se cila është procedura e duhur, nënshkrimi i marrëveshjeve të drejtpërdrejta pa siguruar transparencë dhe mos menaxhimi i kontratave, kanë rezultuar që këto shërbime mos të arrijnë efikasitetin dhe efektivitetin e duhur, ku janë dhënë 10 rekomandime.

8. Menaxhimi i parkingjeve publike në qytetin e Prishtinës nga Ndërmarrja Publike Lokale Prishtina Parking:

- **Entitetet e përfshira në auditim janë:** Ndërmarrja Publike Lokale Prishtina Parking.
- **Mesazhi i auditimit:** Ndërmarrja Prishtina Parking dhe Inspektorati i Komunës së Prishtinës nuk janë treguar efikas dhe efektiv në menaxhimin dhe monitorimin e zbatimit të rregullores për një organizim të mirëfilltë të parkingjeve publike. Ndërmarrja Prishtina Parking është ende në konsolidim, përcillet me ndryshime rregullative, kontrollet janë të dobëta dhe ka raste që nuk janë në gjendje të dëshmojnë aktivitetet e tyre. Një numër i konsiderueshëm i lejeve të parkimit janë lëshuar pa dokumentacionin e nevojshëm. Ndërmarrja nuk ka arritur të realizojë digjitalizimin e sistemit të parkingjeve me laura dhe shenjëzimin e parkingjeve si dhe ka procese të dobëta të kontrollit të brendshëm dhe financiar, ku janë dhënë 12 rekomandime.

9. Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave nga zonat rurale nëpërmjet përfshirjes së tyre në tregun e punës:

- **Entitetet e përfshira në auditim janë:** Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë dhe Agjencia e Punësimit.
- **Mesazhi i auditimit:** Konkluzioni i auditimit tregon se ende nuk janë arritur rezultate të kënaqshme për fuqizimin e gruas dhe sidomos përfshirjen e grave nga zonat rurale në tregun e punës. Programet e Zhvillimit Rural, të parapara për fuqizimin e grave në tregun e punës, dhe përcaktimi i masave afirmative për këtë qëllim nuk kanë arritur të sigurojnë një përkrahje të barabartë për të dy gjinitë. Nuk ka një vlerësim sistematik institucional për menaxhim të projekteve në bazë gjinore apo rreth arritjes së qëllimeve të programit nga kjo perspektivë. Po ashtu ka mungesë të informacionit dhe pengesat e komunikimit si dhe Agjencia e punësimit nuk posedon të dhëna të ndara në baza gjinore, sipas zonave urbane dhe rurale, ku janë dhënë 10 rekomandime.

10. Auditim paralel me KLSH (Shqipëri) dhe ESHRRMV (Maqedoni e Veriut) Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave nga zonat rurale nëpërmjet përfshirjes së tyre në tregun e punës:

- **Entitetet e përfshira në auditim janë:** Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë dhe Agjencia e Punësimit.
- **Mesazhi i auditimit:** Masat dhe aktivitetet për promovimin e barazisë gjinore të grave nga zonat rurale përmes përfshirjes së tyre në tregun e punës, të ndërmarra nga institucionet publike kompetente në Republikën e Maqedonisë së Veriut, Shqipërisë dhe Kosovës, nuk janë mjaft efikase dhe efektive për të përfshirë gratë nga zonat rurale në tregun e punës dhe për t'i mbajtur ato në zonat rurale. Institucionet publike kompetente në të tri vendet kanë ndërmarrë një sërë aktivitete për të forcuar pozitën e gruas në shoqëri, por ende nuk janë arritur rezultate të kënaqshme për përfshirjen e grave nga zonat rurale në tregun e punës, rekomandimet janë të përfshira në auditimin "Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave nga zonat rurale nëpërmjet përfshirjes së tyre në tregun e punës".

11. Efektiviteti i fondeve për financimin e sportit:

- **Entitetet e përfshira në auditim janë:** Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Administrata Tatimore e Kosovës.
- **Mesazhi i auditimit:** Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit nuk ka arritur t'i mbajë përgjegjës organizatat të cilat i financon dhe atyre që përfitojnë vërtetim sponsorizimi nga bizneset private. Një pjesë e madhe e organizatave sportive nuk kanë raportuar se si i kanë shpenzuar fondet e subvencionimit dhe kanë përfituar në vazhdimësi. Ndërsa Administrata Tatimore e Kosovës nuk ka arritur t'i identifikoj dhe të ndërmarrë masat ligjore ndaj kompanive të cilat janë liruar nga tatimi për sponsorizim dhe të cilat nuk i kanë dhënë fondet për sponsorizim. Organizatat sportive gjatë viteve 2020-2022, nuk kanë raportuar për shpenzimet e subvencioneve në vlerë prej 3.5 milionë euro të financuara nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, si dhe Sponsorizimi dhe lirimi i tatimit për kompanitë private ka rezultuar me shmangie tatimore, ku janë dhënë 10 rekomandime.

12. Modernizimi i Sistemit të Edukimit në Kosovë përmes e-Edukimit:

- **Entitetet e përfshira në auditim janë:** Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit.
- **Mesazhi i auditimit:** Ministria ka dështuar në projektin për digjitalizimin e arsimit para-universitar. Ky projekt i financiar plotësisht nga huamarrja është realizuar pa planifikim paraprak i cili është përcjell me mangësi gjatë zhvillimit që kanë ndikuar në mos arritjen e qëllimit dhe përmbushjes

së misionit të organizatës. Për më tepër, Ministria nuk ka siguruar pajisjet thelbësore dhe infrastrukturën harduerike dhe të rrjetit për qëllime të këtij projekti. Sistemi i zhvilluar nuk ka arritur të zbatohet në shkollë për shkak të mungesës së pajisjeve të nevojshme dhe qasjes në rrjet për përdoruesit. Rrjedhimisht, ky sistem është jo funksional, duke rezultuar në dëmtim të buxhetit të Kosovës rreth 5.6 milion euro, të cilat janë huamarrje dhe duhet të paguhen deri në vitin 2032 nga Buxheti i Kosovës, ku janë dhënë 6 rekomandime.

13. Sistemi Informativ për Menaxhimin e Stokut Farmaceutik:

- **Entitetet e përfshira në auditim janë:** Ministrinë e Shëndetësisë, përkatësisht Departamenti i Sistemit të Informimit Shëndetësor dhe Divizioni i Farmacisë, Barnatorja Qendrore e QKUK/ShSKUK-së, Klinika Onkologjike, Klinika Neurologjike, Spitali i Përgjithshëm në Gjilan dhe QKMF në Suharekë.
- **Mesazhi i auditimit:** MSh-ja nuk ka arritur të zbatoj plotësisht SMSF në të gjitha nivelet shëndetësore edhe pas investimeve mbi 6.1 milion euro në shtrirje të infrastrukturës harduerike, që të mundësojë zbatimin e sistemeve të informacionit shëndetësor, përfshirë edhe SMSF-në. Sistemi SMSF nuk shfrytëzohet nga të gjitha njësitë shëndetësore dhe shumica e barnatoreve të reparteve të spitaleve dhe klinikave dhe QMF-ve nuk realizojnë transaksione në SMSF deri të dalja për pacient. Gjithashtu, MSh-ja dhe ShSKUK-ja nuk i kanë harmonizuar PSO-të me proceset e punës në SMSF. Kjo rezulton me menaxhim jo të mirë të stokut farmaceutik dhe në planifikim jo të mirë për alokimin e burimeve në blerjen e medikamenteve, vështirësi në monitorimin e ISH-ve për shpenzimin e stokut dhe shfrytëzimin sa më racional të barnave dhe materialit medicinal të shpenzuar nga ISH-të, ku janë dhënë 16 rekomandime.

14. Sistemet e Informacionit në Doganën e Kosovës - ASYCUDA World:

- **Entitetet e përfshira në auditim janë:** Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Dogana e Kosovës, Pikat Doganore, Cargo dhe Porti i Durrësit.
- **Mesazhi i auditimit:** MSh-ja nuk ka arritur të zbatoj plotësisht SMSF në të gjitha nivelet shëndetësore Dogana e Kosovës ka bërë përparime drejt digjitalizimit të proceseve doganore duke mundësuar automatizimin e një pjese të konsiderueshme të procedurave doganore, duke përshpejtuar proceset dhe duke mundësuar shkëmbimin e të dhënave në kohë reale. Megjithatë Dogana e Kosovës ka mangësi në politikat e kontraktimit, pasi që nuk kanë adresuar mbrojtjen e sigurisë së informacionit në marrëveshjet-kontratat që kanë me palët e jashtme në projektin për sistemin ASYCUDA. Po ashtu kontrollet që zbatohen për mbrojtjen e sigurisë së informacionit në Doganën e Kosovës nuk garantojnë mjaftueshëm integritetin, konfidencialitetin dhe disponueshmërinë e sistemit. Dogana e Kosovës nuk ka siguruar mekanizma të mjaftueshëm për vazhdimësinë e biznesit si dhe kontrollet e aplikacionit që zbatohen në ASYCUDA nuk sigurojnë që vetëm të dhëna të sakta dhe të vlefshme vendosen dhe azhurnohen në sistem. Pasi që disa procese ende realizohen në formë manuale, siç është kalkulimi i koeficientit për përcaktimin e çmimit pas ri-vlerësimit; vlerësimi i rrezikut përmes kriterëve që janë të vendosura vetëm në formë tekstuale, pa lënë mundësi matje, ku janë dhënë 11 rekomandime.

3.6. Kontrolli i cilësisë

Menaxhimi i cilësisë në procesin e auditimit realizohet në përputhje të plotë me vizionin, misionin dhe mandatin e Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA), si një institucion i besueshëm, përmes realizimit të auditimeve cilësore. Qëllimi kryesor i auditimit është të ofrojë siguri për palët e interesit dhe publikun e gjerë në lidhje me cilësinë e raporteve financiare dhe menaxhimit financiar, duke e arritur këtë përmes kontrollit, monitorimit dhe sigurimit të cilësisë.

Rëndësia e realizimit të auditimeve sipas Standardeve Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI) përfshin disa aspekte kryesore, si:

- Sigurimi i cilësisë në auditimet e realizuara.
- Forcimi i besueshmërisë së palëve të interesit në raportet e auditimit.
- Rritja e transparencës së procesit të auditimit.

Sistemi ynë për menaxhimin e cilësisë bazohet në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare për Menaxhimin e Cilësisë, SNISA 140. Ne ofrojmë auditime me cilësi të lartë në pajtueshmëri me udhëzuesit e auditimit, rregulloret dhe aktet e tjera që rregullojnë aktivitetet e ZKA-së. Këto akte përcaktojnë metodologjinë e realizimit të auditimeve dhe ofrojnë udhëzime dhe informacione të nevojshme për të ndihmuar auditorin gjatë procesit të auditimit në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA), parimet e INTOSAI, dhe udhëzimet e Kornizës së Deklaratave Profesionale të INTOSAI (KDPI).

Në të gjitha auditimet e realizuara, ZKA siguron menaxhimin e cilësisë përmes tre komponentëve: kontrolli, monitorimi dhe sigurimi i cilësisë, sistem ky i cili realizohet në disa nivele, përfshirë udhëheqësin e ekipit të auditimit dhe Drejtorin e Auditimit. Departamenti për Sigurimin e Cilësisë në Auditim ka përgjegjësinë për rishikimin e planifikimeve dhe auditimeve të realizuara.

Gjatë vitit 2024, përzgjedhja e auditimeve për rishikim nga ky departament është bërë duke marrë parasysh madhësinë, kompleksitetin e auditimeve dhe mbulueshmërinë e ekipeve të auditimit gjatë procesit të rishikimit të dosjeve të auditimit. Për sezonin auditues 2023/24, Departamenti për Sigurimin e Cilësisë ka realizuar 31 rishikime, prej të cilave:

- 20 rishikime të dosjeve të auditimit financiar dhe të pajtueshmërisë për fazën e ekzekutimit dhe raportimit;
- shtatë rishikime të dosjeve pas publikimit të raporteve të auditimit;
- katër rishikime të dosjeve për auditimet e kryera nga kompani të jashtme audituese të kontraktuara nga ZKA.

Për sezonin auditues 2024/25, Departamenti për Sigurimin e Cilësisë ka realizuar 23 rishikime siç janë:

- 19 rishikime për fazën e planifikimit të auditimeve;
- katër rishikime për auditimet e kryera nga kompani të jashtme audituese.

Për auditimet e performancës, monitorimi dhe kontrolli i cilësisë është një proces i domosdoshëm në çdo auditim. Të gjitha fazat e planifikimit, ekzekutimit dhe raportimit janë subjekt i rishikimit nga nivelet menaxheriale. Rishikimi kolegjial për memorandumit e parastudimit dhe draft-raportin e auditimit bëhet nga auditorë me përvojë brenda divizionit. Për disa tema, ZKA angazhon këshilltarë të jashtëm nga Zyra Kombëtare e Auditimit të Suedisë (SNAO) për të siguruar një proces auditimi të cilësisë së lartë.

3.7. Bashkëpunimi me organet e sundimit të ligjit

Në përputhje me nenin 24 të Ligjit nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, Auditori i Përgjithshëm ka obligim të njoftojë organet kompetente për zbatimin e ligjit në rastet kur identifikon shkelje ligjore.

Marrëveshja e Bashkëpunimit ndërmjet Zyrës Kombëtare të Auditimit dhe Prokurorisë së Shtetit, ka për synim kryesor forcimin e bashkëpunimit në trajtimin e rasteve që rrjedhin nga raportet e auditimit të ZKA-së.

Departamenti për Çështje Juridike dhe Kundër Mashtrimit ka dërguar 53 raste në Prokurorinë e Shtetit. Identifikimi i rasteve kryesisht përfshiu procesin e prokurimit, lidhjen e kontratave, si dhe shpenzimet në kategoritë e investimeve kapitale, mallrave dhe shërbimeve, dhe pasurisë, ku janë identifikuar 42 raste. Ndërkaq, 10 raste të tjera janë identifikuar në fusha të tjera, të cilat lidhen me kategoritë e subvencioneve dhe transfereve dhe një raport i auditimit të performancës.

04

**Menaxhimi Financiar dhe
Administrativ**

Kapitulli IV - Menaxhimi Financiar dhe Administrativ

4.1. Menaxhimi financiar

Zyra Kombëtare e Auditimit financohet nga buxheti i shtetit, i cili menaxhohet dhe shpenzohet me përgjegjësi dhe llogaridhënie të lartë. Bazuar në Ligjin nr. 08/L-260 mbi ndarjet buxhetore për vitin 2024, mjetet e ndara për ZKA-në ishin në shumë 3,345,655€, përderisa buxheti final në fund të vitit ishte 3,093,395€. Buxheti i ndarë dhe shpenzimi në tre vitet e fundit është prezantuar në tabelën në vijim:

Tabela 4. Shpenzimi i buxhetit final përgjatë tri viteve 2024-2022 (në EUR '000)

Raporti i buxhetit	Buxheti fillestar	Buxheti Final	Buxheti i shpenzuar	Shpenzimi krahas Buxhetit Final në %
2024				
Buxheti i përgjithshëm	3,346	3,093	2,926	95%
Pagat dhe shtesat	2,388	2,168	2,168	100%
Mallrat dhe shërbimet	768	729	603	83%
Shërbimet komunale	40	40	33	83%
Investimet kapitale	150	156	122	78%
2023				
Buxheti i përgjithshëm	3,267	3,052	2,877	94%
Pagat dhe shtesat	2,414	2,173	2,171	100%
Mallrat dhe shërbimet	738	765	633	83%
Shërbimet komunale	40	40	36	90%
Investimet kapitale	74	74	37	50%
2022				
Buxheti i përgjithshëm	3,066	3,046	2,785	91%
Pagat dhe shtesat	2,291	2,291	2,154	94%
Mallrat dhe shërbimet	685	685	572	84%
Shërbimet komunale	40	40	35	88%
Investimet kapitale	50	30	24	80%


Shpenzimi në vitin 2024 ishte 2,926,258€ apo 95% e buxhetit final, me një rritje të shpenzimit për 1% krahas vitit paraprak.

Në përputhje me paragrafin 9, neni 15, të Ligjit nr.08/L-260 mbi ndarjet buxhetore për vitin 2024, me vendimet e Qeverisë, në emër të kursimeve ishte zvogëluar buxheti për kategoritë:

- Paga dhe Shtesa janë zvogëluar në vlerë 219,180€ bazuar në vendimin Nr. 03/239 të datës 24.12.2024. Fillimisht është miratuar ndarja buxhetore 2,387,555€, përderisa numri i miratuar i personelit ishte 180 pozita. Ky buxhet është ulur për shkak të lëvizjeve të punonjësve¹⁴:
- Mallra dhe Shërbime janë zvogëluar në vlerë 60,000€, bazuar në vendimin Nr.14/238 të datës 18.12.2024. Fillimisht është miratuar ndarja buxhetore 768,100€ duke u zvogëluar në 708,100€, përderisa me buxhet final janë shtuar 20,621€ nga donacioni i SAI të Arabisë Saudite.

ZKA ka realizuar të hyra në vlerë 28,690€, në emër të shitjes së shërbimeve të auditimit, për projektin Mbështetje për Integritet të Kosovës i financuar nga MPJ e Norvegjisë dhe i zbatuar nga Zyra e Kryeministrit dhe Helvetas Swiss Intercooperation Kosovo (HSIK-DEMOS). Këto të hyra nuk shpenzohen nga ZKA-ja, por transferohen drejtpërdrejt në buxhetin e Kosovës.

Grafiku 3. Shpenzimet krahas buxhetit final sipas kategorive ekonomike në vitet 2024-2022




Krahas buxhetit final nëpër kategori ekonomike në përqindje, për vitin 2024 kategoria e pagave dhe shtesave është shpenzuar 100%, mallrat dhe shërbimet 83%, shërbimet komunale 83% dhe investimet kapitale 78%. Niveli i ulët i shpenzimeve kapitale ka rrjedh si pasojë e mosliferimit të dy veturave të planifikuara (kontratë e menaxhuar nga AQP).

Gjithsej shpenzimi 2,926,958€ për vitin 2024 është shpërndarë në kategori të ndryshme ekonomike, ku çdo kategori ka peshën e saj në përqindje të caktuar në raport me shumën totale si: paga dhe shtesa 74%, mallra dhe shërbime 21%, shpenzime komunale 1% dhe investime kapitale 4%.

14 Gjatë vitit 11 punonjës kanë dhënë dorëheqje, një është pensionuar, katër në pushim pa pagesë dhe pesë në pushim të lehonisë.


Grafiku 4. Pesha e shpenzimit sipas kategorive ekonomike në përqindje për vitin 2024



Në vitin 2024 buxheti nëpër kategori është shpenzuar kryesisht në:

- **Paga dhe shtesa** – janë shpenzuar 2,168,374€ për stafin auditues dhe mbështetës.
- **Investime kapitale** – janë shpenzuar 121,943€ për dy projekte kapitale. Blerja e pesë veturave të reja zyrtare për nevoja të stafit në vlerë 114,825€, blerja e një serveri për përforcim të infrastrukturës së telekomunikimit në vlerë 5,699€ si dhe një inverter për nevoja të furnizimit konstant me rrymë të dhomës së serverëve në vlerë 1,420€ i cili ishte donacion i SAI-t nga Arabia Saudite.
- **Mallra dhe shërbime** – janë shpenzuar 602,811€, sqaruar në mënyrë analitike në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 5. Shpenzimet analitike në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve



- Qiraja, ZKA vazhdon të veprojë në objekt privat, ku qiraja përbën shpenzimin më të lartë në këtë kategori, duke arritur kështu vlerën prej 168,407.00€ apo 28% të shpenzimeve;
- Mirëmbajtjet, ku përfshihen mirëmbajtja higjienike dhe sigurimi fizik i selisë së ZKA-së, mirëmbajtja e pajisjeve të teknologjisë informative dhe mirëmbajtja e automjeteve zyrtare të ZKA-së, në vlerë 156,192€ apo 26%;
- Shpenzimet intelektuale këshillëdhënëse, ku përfshihen shpenzimet e kontraktimit për auditimin e 10 komunave dhe 12 institucioneve të pavarura në vlerë 55,023€ apo 9%;
- Pajisjet dhe furnizime për zyrë, përbejnë 17,499.00€ ose 3% të shpenzimeve në këtë kategori ekonomike. Këtu janë përfshirë kryesisht pagesat për blerje të pajisjeve të TI dhe furnizime të tjera për zyrë;
- Shpenzimet tjera, në vlerë prej 95,424€ ose 16% e totalit përfshijnë edhe edukimin profesional të stafit, shpenzimet kontraktuale, furnizimin me ushqim dhe pije si dhe shpenzime të ndryshme që lidhen me funksionimin e zyrës;
- Shpenzimet për naftë për nxemje qendrore, për ngrohje qendrore, vetura zyrtare dhe gjenerator përbëjnë vlerën prej 28,754.00€ ose 5% të shpenzimeve nga kjo kategori;
- Shpenzimet e udhëtimit brenda dhe jashtë vendit, përfshijnë shpenzimet për mëditje, udhëtime dhe akomodime gjatë këtyre udhëtimeve zyrtare. Shpenzimet në këta zëra arrijnë vlerën prej 81,512.00€ ose 14% të shpenzimeve. Këtu përfshihen 23,931€ apo 3.96% udhëtimet zyrtare brenda vendit, për kompensimin e ushqimit dhe akomodimin në funksion të kryerjes së veprimtarisë audituese në terren në entitetet të cilat janë larg Prishtinës më shumë se 55km. Përderisa 57,581€ apo 9.55% prezantojnë shpenzimet për udhëtimet zyrtare jashtë vendit. Këto shpenzime prezantojnë pjesëmarrjen më të madhe të stafit në përfaqësime të ndryshme, si: në trajnime, vizita studimore, konferenca me qëllim të ngritjes profesionale, angazhime në

ndarjen e përvojave për auditime të shpejta, në kohë reale, investigative, etj. Poashtu përfshinë, pjesëmarrja në auditimin e ambasadave të Republikës së Kosovës, auditimet paralele me ISA-të partnere jashtë Kosovës si dhe takimet me partnerët ndërkombëtarë me financim nga donatorët. Ndërkohë që ZKA ka mbuluar mëditjet/paranë e xhepit që për rrjedhojë paraqesin shpenzimet minimale për realizimin e një përfaqësimi.

- **Shërbimet Komunale** - janë shpenzuar 33,098€, ku shpenzimi i rrymës përfshin 91% të shpenzimeve.

05

Burimet Njerëzore

Kapitulli V - Burimet Njerëzore

Bazuar në Ligjin Nr. 05/L-055, ZKA ka të aprovuar kornizën e brendshme rregullative përmes së cilës rregullon menaxhimin dhe funksionimin e burimeve njerëzore. Departamenti për menaxhimin e burimeve njerëzore ofron përkrahje profesionale për të gjithë punonjësit e ZKA-së, rrjedhimisht ushtrimi i veprimtarisë është në përputhje të plotë me rregullativën ligjore në fuqi dhe me udhëzuesit dhe politika e INTOSAI dhe EUROSAI.

5.1. Burimet Njerëzore dhe zhvillimi profesional

ZKA menaxhon me burimet njerëzore përmes departamentit përkatës, ku ka krijuar mjedis pune të përshtatshëm, pozitiv, atraktiv dhe i orientuar në rezultate.

Personeli në ZKA ndahet në pesë kategori, si në vijim:

- **Kategori e lartë drejtuese** - përfshin vendet e punës të përcaktuara me nenin 9.2 të Ligjit përkatës për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit;
- **Kategori e mesme drejtuese** - përfshin drejtorët e departamenteve dhe njësive të veçanta organizative;
- **Kategori e ulët drejtuese** - përfshin pozitat e punës "Udhëheqësit e Njësive dhe Divizioneve;
- **Kategori profesionale** - përfshin kategorinë që zbaton detyra profesionale dhe që nuk ka përgjegjësi mbikëqyrëse;
- **Kategori mbështetëse** - përfshin kategorinë e personelit që kryen mbështetje administrative dhe teknike për nevoja të ZKA-së.

Ligji Nr.05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit dhe legjislacioni përkatës në fuqi paraqesin instrumentet juridike që përcaktojnë procedurat dhe parimet kryesore të pranimit dhe avancimit në karrierë të personelit të ZKA-së.

ZKA ka rekrutuar 12 punonjës të rinj, përderisa marrëdhënien e punës e kanë shkëputur 11 punonjës, një ka arritur moshën e pensionimit. ZKA në fund të vitit 2024 kishte 162 punonjës.

Struktura e përgjithshme e personelit përbëhet prej 82% personel auditues dhe 18% personel të përkrahjes profesionale mbështetëse.

Tabela në vijim paraqet të dhënat e personelit, ku përfshihet numri i përgjithshëm i punonjësve, përqindja e gjinisë, mosha mesatare, numri i punonjësve nga komunitetet si dhe përqindja e lëvizjeve/largimeve të punonjësve.

Tabela 5. Personeli i ZKA-së, sipas moshës përgjatë tre viteve të fundit 2024-2022

Viti	Numri i personelit në fund të vitit	Personeli Gjinia Femërore (%)	Personeli Gjinia mashkullore (%)	Mosha Mesatare (vite)	Numri i personelit nga komunitetet	Lëvizja e personelit %
2024	162	56%	44%	44	3	7%
2023	163	56%	44%	43	3	7%
2022	166	55 %	45%	43	4	4%

Numri i personelit është në ulje nga viti në vit, kryesisht për shkak të pagave jo konkurruese për këtë profesion. Lëvizja e personelit edhe këtë vit vazhdon të jetë 7%. Për nga gjinia, stafi i gjinisë femërore është për 12% më i lart se gjinia mashkullore.

Mosha mesatare e nëpunësve të ZKA-së është 44 vjet, prej tyre të moshës prej 25 deri në 50 vjet janë 75 % kurse 25% janë të moshës prej 51 deri në 64 vjet.

Në ZKA, Kategoria e Lartë Drejtuese përbëhet nga:

- Zëvendës Auditori i Përgjithshëm;
- Ndihmës Auditorët e Përgjithshëm dhe Drejtori i Përgjithshëm.

Numri i përgjithshëm në këtë kategori është shtatë, prej tyre dy nga gjinia femërore dhe pesë nga gjinia mashkullore.

Rëndësi të veçantë ndër vite i kemi dhënë krijimit të një balancimi gjinor në institucion dhe me theks në rritjen e numrit të pozitave menaxheriale të udhëhequr nga gjinia femërore.

Në vijim paraqesim të dhënat e personelit në pozita udhëheqëse, ku përfshihet numri dhe përqindja e gjinisë femërore dhe mashkullore.

Tabela 6. Struktura udhëheqëse në të gjitha funksionet në tre vitet e fundit 2024-2022

Viti	Pozita udhëheqëse (Gjinia Femërore)	Përqindja %	Pozita udhëheqëse (Gjinia Mashkullore)	Përqindja %
2024	37	58%	27	42%
2023	37	54%	31	46%
2022	37	47%	41	53%

Poashtu edhe në pozitat udhëheqëse përqindja më e madhe është e gjinisë femërore, me 16% më shumë se gjinia mashkullore.

Në strukturën udhëheqëse përfshihen:

- Drejtorët e Departamentit të Auditimit;
- Drejtori i Auditimit të Brendshëm;
- Drejtorët e Departamenteve Mbështetëse Funksionale e Administrative;
- Udhëheqësit e Divizioneve; dhe
- Udhëheqësit e Ekipeve.

Personeli Auditues përbën pjesën më të madhe të personelit në institucion.

Në vijim paraqesim të dhënat e personelit auditues sipas kategorisë profesionale audituese:

- Auditor Specialist (departamenti: cilësi, metodologji dhe planifikim strategjik);
- Auditor Senior (auditime financiare dhe pajtueshmëri, auditime të performancës dhe auditime të teknologjisë së informacionit);
- Auditor (auditime financiare dhe pajtueshmëri, auditime të performancës dhe auditime të teknologjisë së informacionit);
- Auditor Junior (auditime financiare dhe pajtueshmëri dhe auditime të performancës).

Tabela 7. Pozitat në kategoritë audituese profesionale sipas viteve 2022-2024

Viti	Financiar & Pajtueshmëri			Performancë Prokurim & TI			Auditor Specialist
	Auditor Senior	Auditor	Auditor Junior	Auditor Senior	Auditor	Auditor Junior	
2024	48	15	18	9	6	3	6
2023	51	15	19	10	3	6	7
2022	56	15	17	13	1	6	5

Zhvillimi i karrierës në kuadër të ZKA-së është i rregulluar me procedurë ligjore dhe përfshin lëvizjen brenda kategorisë dhe ngritja në detyrë.


Në vitin 2024 janë promovuar nëntë punonjës në nivelet profesionale: Auditor dhe Auditor Senior.

5.2. Zhvillimi profesional dhe trajnimi i personelit

Në zhvillimin e kapaciteteve institucionale është investuar përmes përkrahjes së zhvillimit profesional, krijimit të kushteve për angazhim maksimal dhe promovimit të kulturës së bashkëpunimit të cilat rezultojnë në përmbushjen e obligimeve ligjore, arritjen e rezultateve me auditime të besueshme, efikase dhe efektive.

Personeli auditues është anëtar në shoqatat profesionale të licencuara për kontabilitet dhe auditim, ku në baza vjetore ndjek modulet obligative për Edukim të Vazhdueshëm Profesional (EVP). Përveç trajnimeve dhe edukimit të vazhdueshëm profesional, ka fituar thirrjet e nevojshme certifikuese sipas niveleve profesionale.

Grafiku 6. Personeli i certifikuar i ZKA-së, nëpër nivele në skemat e certifikimit



Numri i përgjithshëm i personelit të certifikuar në skemën e certifikimit publik është 102, prej tyre 83 auditorë të certifikuar në sektorin publik, 15 auditorë të sektorit publik dhe katër asistentë - auditor në sektorin publik. Personeli auditues i angazhuar në auditimet e performancës është përkrahur në vazhdimësi edhe nga Zyra Kombëtare e Auditimit të Suedisë me theks në kuadër të programit për Zhvillimin e Kapaciteteve Intitucionale, duke rezultuar me certifikime të suksesshme të 12 auditorëve. Në fushën e Auditimeve të Teknologjisë të Informacionit janë dy auditor të certifikuar dhe një auditor është në proces të certifikimit.


Njohuritë profesionale ekzistuese personeli i ZKA-së i zhvillojnë përmes ndjekjes së trajnimeve. Identifikimi i nevojave për trajnim bëhet gjatë vlerësimit vjetor të performancës. Departamenti për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në bashkëpunim me Departamentin për Metodologji në Auditim koordinon aktivitetet dhe kontribuon në hartimin dhe zbatimin e Planeve të Trajnimit. Gjithashtu Departamenti për sigurimin e cilësisë nga rishikimet identifikon çështje me rëndësi të cilat do të përkthehen në formë të trajnimeve për personelin auditues.

Auditorët e performancës certifikohen nga Zyra Kombëtare e Auditimit të Suedisë (SNAO). Në maj 2024 në SNAO u mbajt moduli i fundit i trajnimit rajonal për auditimet e performancës për auditorët e Institucioneve Supreme të Auditimit të Kosovës, Shqipërisë, Malit të Zi, Maqedonisë së Veriut dhe Turqisë. Nga ZKA programin e kanë ndjekur dhe janë certifikuar pesë auditorë të performancës. Ky aktivitet është zhvilluar me mbështetjen e Grupit Punues për Aktivitete të Përbashkëta për Auditim, bashkëudhëheqës i të cilit është SNAO, që ofron mbështetje në procesin e zhvillimit institucional dhe negociatave për anëtarësim në BE.

Në prill 2024 në Oslo të Norvegjisë, Iniciativa për Zhvillim e INTOSAI-t (IDI) organizoi punëtorinë për të diskutuar kompetencat e duhura të auditorëve të sektorit publik, në projektin e ri “Analiza e të Dhënave gjatë Auditimit të ISA-ve” në nivel eksperti, falë vlerësimit të lartë për punën dhe angazhimin e saj të shquar në projektin paraprak “LOTA Pioneers”. Po ashtu auditorët e ZKA-së ishin pjesë në dy aktivitete të rëndësishme mbi sigurinë kibernetike dhe inteligjencën artificiale të mbajtur në Oslo të Norvegjisë.

Auditorët e performancës janë pjesë e ekipit profesional të projektit të IDI dhe përfunduan me sukses Programin GAO Followship në SHBA. Programi zgjati 12 javë, duke sjellë avancimin e njohurive në teknikat për kryerjen e auditimeve të performancës, zhvillimin e leadershipit si dhe forcimin e kapaciteteve institucionale të ISA-ve dhe shkëmbimin e njohurive. Programi u mbajt në Zyrën Qeveritare për Llogaridhënie në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Washington DC, ndërsa bashkëfinancues i ZKA-së ishte Aktiviteti i USAID-it për Integritet të Komunave të Kosovës.

Nga plani i trajnimeve për vitin 2024 kanë përfituar i gjithë personeli i ZKA-së.



Personeli i ZKA-së ka marrë pjesë në 38 aktivitete të zhvillimit profesional të organizuara nga stafi i brendshëm i ZKA-së dhe shoqatat profesionale, përveç tyre janë zhvilluar punëtori dhe vizita studimore jashtë vendit.


5.3. Shërbimet e përbashkëta

Departamenti për shërbime të përbashkëta ofron shërbime përkatëse për personelin. Në kuadër të këtij departamenti janë: divizioni për logjistikë, divizioni për administrim të dokumenteve zyrtare dhe divizioni për përkthime.

- **Divizioni për logjistikë**, ofron mbështetje të vazhdueshme për ekipet audituese, duke ofruar shërbime të transportit si dhe të përkrahjes administrative përmes furnizimeve me material të nevojshëm. ZKA është furnizuar me pesë vetura të reja zyrtare, përderisa katër vetura në posedim nga viti 2005 janë zhvlerësuar plotësisht dhe janë në proces të tjetërsimit.

Në vijim janë paraqitur vlerat neto të pasurive kapitale dhe jokapitale:

Grafiku 7. Pasuritë kapitale dhe jokapitale sipas viteve 2022-2024



Rritja e pasurisë kapitale neto është rezultat i blerjeve të vitit ndërsa ulja e vlerës neto të pasurive jokapitale (nën 1,000 €) përgjatë viteve është si rezultat i zhvlerësimit të tyre.

Në fund të vitit, me vendim të Auditorës së Përgjithshme është themeluar komisioni për inventarizim të pasurive të ZKA-së, i cili ka përgatitur dhe dorëzuar raportin e inventarizimit, ku janë evidentuar konkluzione dhe rekomandimeve rreth pasurive të ZKA-së.

- **Divizioni për administrimin e dokumenteve zyrtare**, në bashkëveprim me departamentin e TI-së ka vazhduar me menaxhimin/arkivimin elektronik të dokumenteve zyrtare. Përmes platformës elektronike, auditorët kanë qasje në dokumentet e arkivuara, të cilat janë të nevojshme për punët vijuese në auditim. Të njëjtat, gjithashtu përmes email-it, janë shpërndarë tek personat adekuat. Në vitin 2024, ky divizion ka protokolluar 2,355 dokumente të ndryshme. Ri-gjetja elektronike ka vijuar me efikasitet optimal.
- **Divizioni për përkthime**, ofron shërbimin e përkthimit të dokumenteve zyrtare në gjuhën angleze, serbe dhe anasjelltas, përkthimin e drejtpërdrejtë në takimet, konferencat, punëtoritë dhe trajnimet e organizuara nga ZKA, si dhe në terren me ekipet e auditimit kur është e nevojshme. Gjithashtu, ky divizion mbulon nevojat për përkthim të dokumenteve dhe angazhimeve të

ndryshme që dalin nga bashkëpunimi i ZKA-së me partnerë ndërkombëtar. Për të mbuluar volumin e madh të nevojave për përkthim të dokumenteve brenda afateve të caktuara ligjore, edhe gjatë vitit 2024 është angazhuar kompania për ofrimin e përkthimeve në këto dy gjuhë.

5.4. Teknologjia informative

Departamenti i Teknologjisë së Informacionit (TI), u përqendrua në modernizimin e teknologjisë, përmirësimin e sigurisë kibernetike dhe sigurimin e vazhdimësisë operacionale për të mbështetur punën e auditorëve.

Departamenti i TI-së vazhdon ciklin e planifikuar të përditësimit të llaptopëve, për të siguruar që auditorët të kenë pajisje adekuate për të kryer detyrat në mënyrë efikase.

Është bërë përditësimi i sigurisë së rrjetit përmes azhurnimit të firewall-it, duke rritur mbrojtjen kundër kërcënimeve kibernetike. Forcimi i masave të kopjes rezervë dhe rikuperimit të të dhënave, duke siguruar vazhdimësinë e operacioneve në rast të incidenteve teknike.

Është finalizuar dizajnimi i databazës së rekomandimeve, e cila tani integrohet automatikisht me Sistemin për Menaxhimin e Auditimit (SITA). Kjo databazë përmbledh rekomandimet dhe statusin e tyre për secilin entitet të audituar, duke mundësuar monitorim më të lehtë dhe rritjen e transparencës.

5.5. Prokurimi

Në përputhje me Planin Vjetor të Prokurimit të vitit 2024, janë zhvilluar 41 aktivitete prokurimi të cilat kryesisht kanë qenë për furnizime, kryerje të shërbimeve dhe investime kapitale.

06

**Komunikimi dhe
bashkëpunimi me
palët e jashtme**

Kapitulli VI - Komunikimi dhe bashkëpunimi me palët e jashtme

6.1. Komunikimi me mediat, qytetarët, organizatat e shoqërisë civile, donatorët dhe palë të tjera

Në funksion të rritjes së transparencës dhe forcimit të llogaridhënies në menaxhimin e financave publike, ZKA ndërvepron në mënyrë të vazhdueshme dhe konstruktive me partnerët strategjik dhe palët e interesit. Ky angazhim synon të informojë publikun dhe palët e jashtme për rolin dhe mandatin e Auditorit të Përgjithshëm dhe Zyrës Kombëtare të Auditimit.

Gjatë vitit 2024, AP ka mbajtur pesë konferenca për media për të prezantuar gjetjet dhe rekomandimet e auditimeve. Konferencat kanë ndihmuar në informimin e publikut dhe institucioneve mbi gjetjet e auditimeve, duke rritur transparencën dhe llogaridhënien në menaxhimin e fondeve publike.

Raportet e auditimit dhe aktivitetet kanë pasur një prezencë të theksuar në media, duke u publikuar 1,090 artikuj. Gjatë kësaj periudhe janë vënë në dispozicion informatat e kërkuara nga organizatat e shoqërisë civile, mediat dhe qytetarët. Përveç kanaleve tradicionale të komunikimit, është rritur edhe prezenca në rrjetet sociale, veçanërisht në Facebook dhe LinkedIn.

Po ashtu, ueb faqja e ZKA-së ka shërbyer si burim kryesor i informacionit, duke i ofruar publikut qasje të lehtë në raportet e auditimit dhe përmbajtje të tjera relevante.

Fotogaleri. Konferencat e mbajtura të AP-së



6.2. Bashkëpunimi i ZKA-së me Kuvendin e Kosovës

Në përputhje me detyrimet ligjore për raportim por edhe në aspektin e partneritetit për të rritur ndikimin dhe shkallën e zbatimit të rekomandimeve të auditimit në mbështetje të llogaridhënies dhe qeverisjes së mirë, bashkëpunimi me Kuvendin e Republikës së Kosovës është intensifikuar kryesisht përmes punës me Komisionin për Mbikëqyrje të Financave Publike (KMFP) dhe Komisionin për Buxhet, Punë dhe Transfere (KBPT).

Në përputhje me mandatin kushtetues dhe ligjor, Auditorja e Përgjithshme ka dorëzuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës, Raportin Vjetor të Performancës të Zyrës Kombëtare të Auditimit, për vitin 2023 dhe Raportin Vjetor të Auditimit të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2023 dhe 127 raporte individuale të auditimit, poashtu edhe Planin Vjetor të Auditimit për sezonin auditues 2024/2025.

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike ka shqyrtuar 24 raporte të auditimit për organizatat buxhetore për të cilat ZKA ka përgatitur përmbledhjet e raporteve në dy gjuhë zyrtare, prej të cilave: nëntë raporte të Auditimit të Performancës dhe 15 Raporte të Auditimit Financiar dhe Pajtueshmëri. Komisioni poashtu ka shqyrtuar edhe RVP -2023 bashkë me Raportin e Auditimit për PVF – 2023 të ZKA-së.

Në kuadër të intensifikimit të bashkëpunimit me Kuvendin, AP ka zhvilluar takime dhe aktivitete tjera të përbashkëta me komisionet parlamentare KMFP dhe KBPT. Ndër to vlen të theksohen:

- Me qëllim të shkëmbimit të përvojave, në muajin mars 2024, AP dhe zyrtarë të lartë nga ZKA-ja dhe anëtarët e KMFP-së realizuan vizitë zyrtare në Stokholm të Suedisë. Gjatë kësaj vizite Përfaqësuesit e ZKA-së dhe deputetët e Kuvendit të Kosovës zhvilluan takime me homologët e tyre në Parlamentin e Suedisë si dhe zhvilluan vizitë edhe në Agjencinë Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA).
- AP me bashkëpunëtorë ka pritur në takim delegacionin e Parlamentit të Republikës së Shqipërisë, të kryesuar nga Kryetari i Komisionit të Ekonomisë dhe Financave dhe Kryetaren e Nënkomisionit për Auditimin e Sektorit Publik, si dhe anëtarë të tjerë të komisionit dhe nënkomisionit parlamentar.

6.3. Bashkëpunimi ndërkombëtar, marrëveshjet bilaterale dhe procesi i integritetit në Bashkimin Evropian

ZKA ka forcuar bashkëpunimin ndërkombëtar përmes pjesëmarrjes aktive në organizata dhe rrjete profesionale të auditimit. Ajo ka shkëmbyer përvoja me institucione homologe nga rajoni dhe më gjerë, duke marrë pjesë në konferenca, trajnime dhe projekte të përbashkëta. Gjithashtu, ka thelluar bashkëpunimin në kuadër të organizatave ndërkombëtare si INTOSAI dhe EUROSAI, duke kontribuar në zhvillimin e standardeve dhe praktikave të avancuara të auditimit. Ky angazhim ka ndihmuar në rritjen e transparencës dhe efikasitetit të auditimeve publike në Kosovë. Në kuadër të bashkëpunimit bilateral, AP ka zhvilluar takime të rëndësishme me homologët e saj të rajonit dhe më gjerë.

Në muajin maj, AP dhe një delegacion i ZKA-së kanë qëndruar për vizitë zyrtare në Gjykatën Turke të Llogarive. Gjatë vizitës është arritur marrëveshja e cila ndër të tjera parasheh shkëmbimin e përvojave në fusha me interes publik, auditime paralele, shkëmbimin e stafit, ngritjen e kapaciteteve në auditime të performancës dhe të pajtueshmërisë si dhe analizimin e databazave të mëdha. Në përmbushje të kësaj marrëveshje, gjatë muajit dhjetor ZKA ka mbajtur punëtorinë online me temën “Auditimi i Teknologjisë së Informacionit në Zyrën Kombëtare të Auditimit të Kosovës”, ku është prezantuar përvoja dhe zhvillimit institucional në fushën e auditimeve të teknologjisë së informacionit te kolegët e Gjykatës Turke të Llogarive.

Në muajin tetor AP priti në vizitë Kryetarin e KLSH-së të Republikës së Shqipërisë. Vizita kishte për qëllim diskutimin gjithëpërfshirës të temave me interes të përbashkët në shërbim të përmirësimit të auditimit publik në Kosovë dhe Shqipëri. Po ashtu një delegacion i Departamentit për Çështje Juridike dhe Kundër Mashtrimeve të ZKA-së qëndroi për vizitë zyrtare në Kontrollin e Lartë të Shtetit të Shqipërisë.

AP në muajin nëntor është pritur në takim bilateral nga AP i Kroacisë, ku u diskutuan mundësitë e bashkëpunimit dhe shkëmbimit të përvojave ndërmjet të dy institucioneve. Në kuadër të kësaj vizite delegacioni i ZKA-së ka marrë pjesë edhe në shënimin e 30-vjetorit të themelimit të Zyrës Shtetërore të Auditimit të Kroacisë. AP është pritur në takim bilateral edhe nga AP i Maqedonisë së Veriut ku morën pjesë në Konferencën për shkëmbimin e përvojës në proceset e komunikimit të Entit Shtetëror të Revizionit të Maqedonisë së Veriut.

Edhe gjatë këtij viti përfaqësuesit e ZKA-së kanë vazhduar angazhimin aktiv dhe kontributin profesional në gjashtë grupe punuese të EUROSAI-t dhe INTOSAI-t.

AP, e shoqëruar nga ZvAP dhe NAP, në qershor 2024 në Budapest të Hungarisë morën pjesë në takimin e dytë të Grupit punues mbi përfitimet dhe metodologjitë e auditimit në kohë reale, i cili operon nën qëllimin e parë strategjik të EUROSAI-t (bashkëpunimi profesional). Takimi është organizuar nga Institucionet Supreme të Auditimit (ISA) të Hungarisë dhe Italisë. Në kuadër të kësaj vizite, kryetari i Zyrës Shtetërore të Auditimit të Hungarisë, priti në takim të veçantë krerët e ISA-ve të shteteve pjesëmarrëse, duke afirmuar gatishmërinë për bashkëpunim ndërinstitucional përmes zhvillimit të aktiviteteve bilaterale, si dhe në kuadër të EUROSAI-t dhe INTOSAI-t.

Auditorja e Përgjithshme dhe përfaqësuesit e tjerë të ZKA-së kanë marrë pjesë në tri konferenca dhe 10 punëtori e takime ndërkombëtare.

Fotogaleri - Bashkëpunimi rajonal e ndërkombëtar me ISA-të partnere, marrëveshjet bilaterale dhe pjesëmarrja në konferenca dhe punëtori ndërkombëtare



Në kuadër të përmbushjes së obligimeve që lidhen me integrimin evropian, ZKA-ja ka luajtur një rol aktiv në zbatimin e Planit Kombëtar për zbatimin e MSA-së dhe Strategjisë për reformën në Menaxhimin e Financave Publike.

ZKA-ja ka siguruar që të gjitha raportimet të kryhen me kohë dhe në përputhje me standardet e kërkuara, duke përmbushur me sukses masat dhe detyrimet e vendosura në fushën e saj të përgjegjësisë. Përmes auditimeve të fokusuara dhe analizave të thelluara, institucioni ka kontribuar në përmirësimin e transparencës dhe llogaridhënies në menaxhimin e financave publike, duke mbështetur objektivat e reformës dhe përafrimin me praktikën e Bashkimit Evropian.

6.4. Bashkëpunimi dhe marrëveshjet e nënshkruara

Kemi forcuar bashkëpunimin me institucionet shtetërore të Kosovës dhe shoqatat profesionale, me qëllim të rritjes së kapaciteteve profesionale, përmirësimit të qeverisjes dhe rritjes së llogaridhënies në menaxhimin e financave publike.

Në muajin tetor është nënshkruar marrëveshja e bashkëpunimit me Agjencinë për Informim dhe Privatësi (AIP), e cila ka për qëllim mbrojtjen e të dhënave personale dhe sigurisë së sistemeve të informacionit në Republikën e Kosovës.

Në vazhden e bashkëpunimit me shoqatat profesionale dhe me qëllim të zhvillimit të kapaciteteve të stafit, kemi nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me ShKÇAK, Institutin AAB për Kontabilist dhe Auditor të Çertifikuar dhe Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina".

Po ashtu ZKA-në e kanë vizituar edhe ekspertët nga OECD/SIGMA-s, përfaqësues të Misionit të Bankës Botërore, drejtues të Departamentit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit etj.

6.5. Bashkëpunimi ndërkombëtar në Projektin me SNAO

Bashkëpunimi në mes të ZKA-së dhe SNAO përmes projektit bilateral ka vazhduar edhe gjatë vitit 2024, i cili ka sjellë rezultate të rëndësishme për ZKA-në. Arritjet kryesore të këtij bashkëpunimi përfshijnë forcimin e kapaciteteve të ZKA-së për zhvillimin e auditimeve të performancës, sigurimin e cilësisë, përmirësimin e proceseve organizative, zhvillimin e lidershit dhe menaxhimit strategjik. Mbështetja nga projekti poashtu ka përmirësuar komunikimin e brendshëm dhe të jashtëm të ZKA-së, ku projekti ka përfunduar në fund të vitit 2024, dhe tani ZKA dhe SNAO janë në proces të identifikimit të nevojave dhe hartimit të planit për projektin e ri 2025-2030.

Në kuadër të zbatimit të këtij projekti janë mbajtur punëtori, trajnime dhe aktivitete, ku rëndësi të veçantë i është dhënë përdorimit të gjuhës së thjeshtë përkatësisht përmirësimit të shkrimit të raporteve të auditimit.

6.6. Tryezat, punëtoritë dhe konferencat e organizuara nga ZKA-ja

Janë organizuar tryeza konsultative me organizatat e shoqërisë civile dhe palë të interesit, për të forcuar transparencën dhe komunikimin ndërmjet institucioneve shtetërore dhe shoqërisë civile, duke diskutuar për sfidat dhe mundësitë në fushën e auditimit dhe menaxhimit të fondeve publike.

Auditorja e Përgjithshme dhe përfaqësuesit e ZKA-së kanë marrë pjesë në konferenca, punëtori dhe aktivitete të ndryshme vendore.

- Nën organizimin e UN Women për Evropën dhe Azinë Qendrore, në Shkup të Maqedonisë së Veriut u mbajt tryeza për prezantimin e rezultateve nga auditimi i përbashkët rajonal i performancës i Institucioneve Supreme të Auditimit (ISA) të Kosovës, Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut, “Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave nga zonat rurale nëpërmjet përfshirjes së tyre në tregun e punës”, ku Zëvendës Ambasadori i Zvicrës dhe Udhëheqësi për bashkëpunim zhvillimor në Ambasadën e Suedisë në Maqedoninë e Veriut, mbajtën fjalë rasti si mbështetës për realizimin e kësaj iniciative rajonale;
- Në muajin korrik është mbajtur tryezë diskutimi me temë “Strategjia e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimet e performancës dhe përfshirja e shoqërisë civile” e cila kishte për qëllim identifikimin e çështjeve/temave me interes publik për t’u përfshirë në Strategjinë për auditimet e performancës;
- Në tetor 2024, është mbajtur Konferenca Vjetore me temë “Udhëheqja strategjike e ZKA-së, sfidat dhe mundësitë”. Konferenca shërbeu si një mundësi për të reflektuar mbi rrugën e përshkuar, sfidat e hasura dhe mundësitë që shtrihen përpara. Po ashtu u ndanë mirënjohe për jubileun e 20-vjetorit dhe 10-vjetorit të punës për punonjësit e ZKA-së;
- Në muajin dhjetor në bashkëpunim me Prokurorinë e Shtetit dhe me mbështetjen e USAID-KMI u mbajt punëtorja me temë “Harmonizimi i Përkufizimeve të Shkeljeve dhe Udhëzimet për Identifikimin e Veprave Penale”;
- Në muajin dhjetor është mbajtur Konferenca me temë “Ndikimi i auditimit në përmirësimin e qeverisjes lokale dhe transparencës” ku morën pjesë kryetarë të komunave, përfaqësues të tjerë komunal, përfaqësues nga USAID-i, DEMOS-i dhe OSBE-ja;
- ZKA dhe OSBE-së ka mbajtur dy punëtori me komuna për përmirësimin e praktikave komunale të auditimit dhe rritjen e ndikimit e raporteve të auditimit, sfidat kryesore në zbatimin e rekomandimeve të auditimit, hartimin e planeve të veprimit, si dhe përmirësimin e raportimit në kuvendet komunale.

07

**Llogaridhënia dhe
aktivitetet e vitit 2024**

Kapitulli VII – Llogaridhënia dhe aktivitetet e vitit 2024

7.1. Llogaridhënia e Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA)

Pasqyrat Vjetore Financiare të ZKA-së janë dorëzuar dhe janë përfshirë në raportin e Qeverisë për Buxhetin e Kosovës për vitin 2024 në pajtueshmëri me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike. Kuvendi i Kosovës për vitin 2024, nuk ka kontraktuar një kompani audituese për auditimin e PFV të ZKA-së, përderisa në këtë raport janë përfshirë Pasqyrat Vjetore Financiare të pa audituara.

ZKA në kuptim të raportimit financiar dhe performancës, është llogaridhënëse sipas nenit 138 të Kushtetutës së Kosovës dhe nenit 14 të Ligjit Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit.

7.2. Aktivitetet e ZKA-së gjatë vitit 2024

Mbi bazën e Planit Strategjik për periudhën 2023-2026, janë hartuar edhe dokumente tjera që janë të nevojshme si mekanizma për përcjelljen e zbatimit të strategjisë.

Si vazhdimësi e Planit Strategjik të ZKA-së, dhe hartimit të planit operacional, bëhet raportimi 6 mujor dhe vjetor për përcjelljen/monitorimin e aktiviteteve për zbatimin e planit strategjik me qëllim të avancimin të mëtutjeshëm të profesionalizmit në punën auditues në përputhje me qëllimet e planifikuara.

Gjatë vitit 2024 janë përcjell këto aktivitete që janë pjesë e planit strategjik:

Qëllimi 1: Pavarësia, Standardet dhe Cilësia

- Procedimin e ndryshimeve të nevojshme ligjore, në harmoni të plotë me INTOSAI P-10 që do të mundësonte aplikimin e metodologjisë për përzgjedhjen e auditimeve bazuar në rrezik;
- Përcjellja e standardeve të INTOSAI-t dhe përditësimi i doracakëve auditues dhe udhëzuesëve në pajtim me SNISA-t;
- Zhvillimin e Arkivës digjitale, si dhe proceset e ndryshim/plotësimit të rregulloreve të brendshme në frymën e legjislacionit në fuqi;
- Rritja e vazhdueshme e numrit të auditimeve të pajtueshmërisë dhe të performancës që do të rezultojnë me ndikimin e auditimeve në qeverisjen e mirë dhe mirëqenien e qytetarëve.

Qëllimi 2: Kapacitetet dhe Burimet

- Avancimi i menaxhimit të burimeve njerëzore me fokus funksionalizimi i sistemit elektronik (digjitalizimi) për menaxhimin e burimeve njerëzore;
- Avancimi dhe zhvillimi profesional, bazuar në vlerësimin e rezultateve të punës për gjithë stafin për zbatimin e objektivave strategjike;
- Forcimi i mëtejshëm i kontrolleve të brendshme institucionale;

- Fuqizimin e shërbimeve financiare dhe njerëzore;
- Kemi arritur në një zgjidhje për dalje nga objekti me qira për ZKA-në, ku MPB ka nda një objekt në pronësi publike.

Qëllimi 3: Imazhi dhe Ndikimi

- Bashkëpunimi me OB për zbatimin e rekomandimeve dhe avancimi i bazës së të dhënave për zbatimin e rekomandimeve të auditimit;
- Komunikimi i rregullt me komisionet parlamentare, palët e jashtme, shoqërinë civile dhe mediat; dhe
- Pjesëmarrja aktive në aktivitetet e organizatave profesionale të auditimit INTOSAI dhe EUROSAI.

Përpos aktiviteteve që ndikohen nga palët e jashtme (Qeveria, Kuvendi), të tjerat janë në zbatueshmëri sipas planit të aktiviteteve.

Për të arritur objektivat, ZKA ndjek një qasje strategjike të qartë të përcaktuar në Strategjinë e Komunikimit 2023 – 2026 në të cilën përcaktohen dy qëllimet kryesore: 1.Promovimi i rolit kushtetues të ZKA-së dhe rritja e ndikimit të rezultateve audituese në sektorin publik, si dhe 2.Komunikim i brendshëm aktiv me qëllim të mbështetjes së punonjësve dhe promovimit të rezultateve të punës.

Është hartuar Strategjia e TI-së (2025-2027), e cila synon të përshtatë teknologjinë me kërkesat e auditimit duke adresuar tendencat më të fundit në fushën e TI-së. Strategjia fokusohet në 5 objektiva:

- Infrastrukturë Moderne të TI-së;
- Teknologjitë Digjitale për Përmirësimin e Biznesit;
- Përdorimi i teknologjive të reja - Analiza e të Dhënave dhe Inteligjenca Artificiale;
- Qeverisja e TI-së; dhe
- Mësimi dhe zhvillimi i vazhdueshëm.



Foto e përbashkët e Stafit të Zyrës Kombëtare të Auditimit-2024

SHTOJCAT

Shtojca I. Auditimet për Sezonin 2023/24 dhe 2024/25

Në vitin 2024, për sezonin e auditimit 2023/2024 janë publikuar 127 raporte të auditimit:

108 raporte të auditimit financiar me pajtueshmëri:

- **1 Raportin Vjetor të Auditimit për Raportin Financiar Vjetor të Buxhetit të Kosovës, të vitit 2023,**
- **48 Institucione të Nivelit Qendror,**
- **38 Komuna,**
- **12 Ndërmarrje Publike:**
 1. Korporata Energjetike e Kosovës sh.a (KEK);
 2. Hekurudhat e Kosovës -Infrakos sh.a;
 3. Trepça, Sh.A;
 4. KRU,, Prishtina” Sh.A-Prishtinë;
 5. Ndërmarrja Publike Banesore-Prishtinë;
 6. Telekom i Kosovës;
 7. KOSST;
 8. KRM,, Pastrimi” Sh.A-Prishtinë;
 9. KRM,, Uniteti” Sh.A -Mitrovicë;
 10. Ngrohtorja Qendrore “Termokos” – Prishtinë;
 11. NPH “Ibër - Lepenc” Sh.A – Prishtinë;
 12. Hidrodrini Sh.A -Pejë.
- **9 projekte të financuara nga donatorët:**
 1. Konkurrueshmëria dhe gatishmëria për eksportim (MINT-BB);
 2. Eficienca e energjisë së ripërtëritshme-konsolidim (ME-BB);
 3. Ekonomia Digjitale në Kosovë (kode) (ME-BB);
 4. Emergjencia Covid-19 në Kosovë (MSH-BB);
 5. Prona dhe Infrastruktura gjeo-hapësinore (AKK-BB);
 6. Komunat për rininë në Kosovë (MAPL);
 7. Reformën në sistemin e Asistencës Sociale (MFPT);
 8. Programi për shfrytëzimin dhe nxitjen e mundësive për sigurinë e ujit (MMPHI); dhe
 9. Mbështetje për Integritet të Kosovës i financuar nga MPJ e Norvegjisë dhe i zbatuar nga Zyra e Kryeministrit.

14 raporte të auditimit të performancës:

1. Lista e pritjes së pacientëve në Institucionet Shëndetësore Publike;
2. Procesi i Dokumentimit, Vlerësimit dhe Verifikimit në Sistemin për Menaxhimin e Performancës Komunale për vitin 2020;
3. Mekanizmat e sigurimit të cilësisë së të dhënave të raportuara për Sistemin e Menaxhimit të Performancës Komunale dhe Grantin e Performancës Komunale për vitin 2021;
4. Efektiviteti dhe efikasiteti i kontraktimit të shërbimeve Shëndetësore dhe sociale nga institucionet e Republikës së Kosovës;
5. Menaxhimi i licencimeve në Komisionin e Pavarur për Media;
6. Menaxhimi i parkingjeve publike në qytetin e Prishtinës nga Ndërmarrja Publike Lokale Prishtina Parking;
7. Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave nga zonat rurale përmes përfshirjes së tyre në tregun e punës;
8. Auditimi Paralel me KLSH dhe ESHRRMV (Maqedoni e Veriut) Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave nga zonat rurale nëpërmjet përfshirjes së tyre në tregun e punës;
9. Efektiviteti i fondeve për financimin e sportit;
10. Menaxhimi i tokave/pronës nga Instituti Bujqësor i Kosovës;
11. Vlerësimi i procedurave të shitjes direkte të aseteve nën menaxhimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit;
12. Sistemi i Menaxhimit të Stokut Farmaceutik (SMSF);
13. Modernizimi i Sistemit të Edukimit në Kosovë përmes e-Edukimit;
14. Sistemet e Informacionit në Doganën e Kosovës - ASYCUDA World.

2 Auditime të pajtueshmërisë:

1. Dhënia në shfrytëzim e pronave komunale dhe monitorimi i tyre në komunën e Ferizajt për periudhën janar/2022-shtator/2023;
2. Prokurimi dhe menaxhimi i kontratave në Ministrinë e Shëndetësisë për vitin 2023.

3 Auditime me nivel të informatave të klasifikuara

Plani vjetor për sezonin e auditimit 2024/25

Në vitin 2024, për sezonin e auditimit 2024/2025, plan i filluar në shtator të vitit 2024, ZKA planifikon të përfundojë **139** raporte të auditimit:

108 raporte të auditimit financiar dhe pajtueshmërisë:

- **1 Raporti Vjetor i Auditimit për Raportin Financiar Vjetor të Buxhetit të Kosovës të vitit 2024;**
- **49 Institucione të Nivelit Qendror;**
- **38 komuna;**
- **12 ndërmarrje publike:**
 1. Korporata Energjetike e Kosovës, Sh.A (KEK);
 2. Pasqyrat e veçanta për nevoja të ZRRE-së;
 3. Pasqyrat e veçanta KPM;K;
 4. KOSTT; Kompania për Operimin e Sistemit të Transmetimit të Tregut të Energjisë Elektrike
 5. Pasqyrat e veçanta për nevoja të ZRRE-së
 6. Trepça, Sh.A;
 7. KRU “ Prishtina” sh.a – Prishtinë;
 8. Telekom
 9. KRM “ Uniteti” Sh.A – Mitrovicë;
 10. Ngrohtorja Qendrore “Termokos” – Prishtinë;
 11. NPH “Ibër - Lepenc” Sh.A – Prishtinë;
 12. Hidrodrini Sh.A -Pejë.
- **8 projekte që financohen nga huamarrja shtetërore dhe nga donatorët:**
 1. Projekti i Reformës së Sistemit të Asistencës Sociale (BB-MFPT);
 2. Ekonomia Dixhitale e Kosovës (BB-MZHE);
 3. Projekti i Kosovës për Eficiencën e Energjisë dhe Energjinë e Ripërtëritshme (BB-MZHE-Fondi Eficiencë);
 4. Forcimi i qeverisjes dixhitale për ofrimin e shërbimeve (BB-MPB/ASHI);
 5. Përmirësimi dhe Rehabilitimi i Sistemeve të Ujitjes në Kosovë (BB-MBZHR);
 6. Komunat për rininë në Kosovë (BB-MAPL);
 7. Projekti për Infrastrukturën e Pasurive të Paluajtshme dhe Gjeohapësinore (BB-AKK);
 8. Programi për nxitjen dhe shfrytëzimin e mundësive për sigurinë e ujit (BB-MMPHI/Hidromorava).

11 auditime të veçanta të pajtueshmërisë;

3 auditime të informatave të klasifikuara;

17 raporte të auditimit të performancës:

1. Licencimi i institucioneve parashkollore dhe mbikëqyrja e tyre;
2. Eficienca e Energjisë-BRE KOSST;
3. Temë e re;

4. Mbrojtja, Zhvillimi dhe ripërtëritja e hapësirave pyjore;
5. Siguria dhe të drejtat e konsumatorëve;
6. Lejet e ndërtimit Fushë Kosovë;
7. DEMOS;
8. Furnizimi me barna për shëndetësinë primare dhe sëmundjet e rralla;
9. Parkingu nëntokësor në Malishevë;
10. Ndërtimi i objektit të Ortopedisë në QKUK;
11. Platforma e shërbimeve online e-Kosova;
12. Integrimi i sistemeve, krijimi i deponisë së shenimeve dhe implementimi i Intelgjencës së Biznesit;
13. Temë e re;
14. Menaxhimi i sektorit të ndërtimit në Prishtinë;
15. Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës-Infrakos;
16. ASYCUDA World;
17. Auditimi i pajtueshmërisë në KMDK.

Shtojca II. Pasqyrat Financiare Vjetore të ZKA-së për vitin 2024 të pa audituara



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO			
ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT			
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
DATE / DATUM / DATA: 29-01-2025			
Prosta Org.	Shif. klasif.	Nr. Prot.	M. f. f. f. f. f.
Org. Unit	Klasif. Kod	Br. Prot.	Br. Stranica
01	402	49	32



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Për: z. Xhevat Zejnullahu, U.D. Drejtori i Përgjithshëm i Thesarit

Kopje: z. Armend Muja, Kryetar i Komisionit për buxhet, punë dhe transfere
Kuvendi i Republikës së Kosovës

znj. Hykmete Bajrami, Kryetare e Komisionit për mbikëqyrje të financave publike
Kuvendi i Republikës së Kosovës

Lënda: Raporti Vjetor Financiar - 2024

Datë: 29.01.2025

Të nderuar,

Ju lutem gjeni të bashkangjitur Raportin Vjetor Financiar për vitin e përfunduar me datën 31 dhjetor 2024, të përgatitur nga Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës.

Me respekt,



znj. Vlora Spanca

Zyrtar Kryesor Administrativ



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Zyra Kombëtare Auditimit

Raporti Vjetor Financiar

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024

			
REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO			
ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT			
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
DATE PRANIMORRËZUAR DATE PRILIKEDOSTAVLJEN		29-01-2025	
DATE RECEIVED-SUBMITTED			
Njësia Org. Org. Jedin. Org. Unit	Shif. klasif. Klasif. Kod Class. Code	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Nr. i faqeve Br. Stranica No. Pages
01	402	79	32

Protokolli dalës i Organizatës Buxhetore

Protokolli hyrës i Thesarit të Kosovës

Neni 12**DEKLARATË E PASQYRAVE FINANCIARE**

Për: Xhevat Zejnullahu, U.D. Drejtor i Përgjithshëm i Thesarit

Nga: Vlora Spanca, Zyrtar Kryesor Administrativ (ZKA)

Arben Dodaj, Zyrtar Kryesor Financiar (ZKF)

Sipas mendimit tonë, pasqyrat financiare të cilat janë të bashkangjitura, përfshirë shënimet për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024 janë përgatitur sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik të vitit 2017 "Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të bazuar në para të gatshme", i përmblushtin të gjitha obligimet raportuese që dalin nga Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116, Ligjin nr. 04/L-194, Ligjin nr. 05/L-063 dhe Ligjin nr. 05/L-007 dhe janë të bazuara në shënimet financiare të mbajtura në mënyrë të duhur.

Kjo deklaratë jepet në lidhje me prezantimin e Pasqyrave Financiare të organizatës buxhetore për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2024 dhe është pjese përbërëse e pasqyrave financiare.

Në besojmë dhe konfirmojmë, që:

- Nuk ka pasur parregullsi lidhur me udhëheqësin apo me punëtorët, e cila ka mundur të ketë efekt material në pasqyrat financiare.
- Informatat e dhëna dhe të prezantuara në pasqyrat financiare lidhur me burimin e fondeve dhe shpenzimin e tyre të lidhura me Buxhetin e konsoliduar të Kosovës janë të plota dhe të sakta.
- Informatat në lidhje me grumbullimin e të hyrave janë të sakta.
- Nuk ka tjera llogari bankare të Buxhetit të Republikës së Kosovës përveç llogarive bankare të specifikuara në pasqyrat financiare dhe ky specifikim është i plotë dhe i saktë si në datën 31 dhjetor 2024.
- Nuk ka pasur shkelje të kërkesave të autoriteteve rregullatore të cilat kanë mundur të kenë efekt material në pasqyrat financiare.
- Nuk ka ndonjë ankesë (ligjore) në proces e cila mund të ketë efekt material në pasqyrat financiare
- Të gjitha detyrimet, si ato aktuale ashtu edhe kontingjente, dhe të gjitha garancitë që u kemi dhënë palëve të treta janë regjistruar dhe/ose janë shpalosur në mënyrë të duhur.
- Nuk ka pasur asnjë transaksion pas përfundimit të periudhës i cili do të kërkonte korrigjim ose shpalosje në pasqyrat financiare apo në shënimet e tyre.

Sipas mendimit tonë, pasqyrat financiare që janë të bashkangjitura paraqesin një prezantim të vërtetë dhe të paanshëm të financave dhe transaksioneve financiare për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024 të institucionit Zyra Kombëtare e Auditimit.

Data: 29/01/2025

(Nënshkrimi i ZKA)



Data: 29/01/2025

(Nënshkrimi i ZKF)

Neni 13
Pasqyra e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme

Pasqyra e pranimeve dhe pagesave të parave të gatshme për Zyra Kombëtare Auditimit Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor			
	2024	2023	2022
	Llogaria e vetme e Thesarit	Llogaria e vetme e Thesarit	Llogaria e vetme e Thesarit
	BKK	BKK	BKK
	'000	'000	'000
Shënim			
BURIMET E FONDEVE -PRANIMET			
Granti qeveritar	2,925	2,877	2,785
Të hyrat vetanake			
Të hyrat e dedikuara	1		
Grantet e përcaktuara të donatorëve			
Pranimet tjera			
Gjithsej	2,926	2,877	2,785
SHFRYTEZIMI I FONDEVE - PAGESAT			
Operacionet			
Paga dhe shitesa	2,168	2,171	2,154
Mallra dhe shërbime	603	633	572
Shpenzime komunale	33	36	35
	2,804	2,840	2,761
Transferet			
Transfere dhe subvencione			-
Shpenzime kapitale			
Prona, ndërtesa dhe pajisje	122	37	24
Pagesa tjera			
Gjithsej	2,926	2,877	2,785

Neni 14
Raporti i ekzekutimit te buxhetit

		2024				2023	2022
	Shënime	Realizimi A € '000	Buxheti final B € '000	Buxheti fillestar C € '000	Ndryshimi D=B-A € '000	Realizimi E € '000	Realizimi F € '000
8	Të hyrat tatimore				-		
9	Të hyrat jo tatimore	29	26	26	(3)	16	10
10	Të hyrat e dedikuara				-		
11	Grantet e përcaktuara të donatorëve				-	27	
12	Tjera				-		
Gjithsej Pranimet		29	26	-	(3)	43	10
2	Paga dhe shtesa	2,168	2,168	2,388	-	2,171	2,154
3	Mallra dhe shërbime	603	729	768	126	633	572
4	Shpenzime komunale	33	40	40	7	36	35
5	Transfere dhe subvencione				-		
6	Shpenzime kapitale	122	156	150	34	37	24
	Rezerva				-		
7	Tjerat				-		
Gjithsej pagesat		2,926	3,093	3,346	167	2,877	2,785

Shënimi 2 deri 12 Prezantim i ndryshimeve materiale

Për dallim prej shënimeve 2 deri 12, këto shënime përdoren për të sqaruar dallimin **material** në kolonën **D** (neni 14), domethënë dallimin material të realizimit të buxhetit. SNKSP në bazë të parasë se gatshme kërkon të sqarohen dallimet materiale. Varësisht nga madhësia e dallimit, nuk kanë nevojë të ofrohen shpjegime për të gjitha kategoritë, andaj mund të kërkojnë ndryshime në sistemin e numërimit të shënimeve. Kur të sqarohen dallimet e ndonjë kategorie të ndarjes, duhet të jepet përmbledhja e natyrës ndryshimit.

Neni 15: Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare

Shënimi 1

1. Politikat kontabël

